



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME EKONOMIKE DHE E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
DREJTORIA E BUXHETIT DHE MENAXHIMIT FINANCIAR

RAPORTI VJETOR I MONITORIMIT

TË BUXHETIT

PËR

VITIN 2025

PËRMBAJTJA

1- HYRJE

1.1 Misioni i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë

1.2 Fushat e Përgjegjësisë Shtetërore

1.3 Programet Buxhetore

2- INFORMACION BUXHETOR I AGREGUAR

3- PERFORMANCA E TREGUESVE KYÇ TË PËRFORMANCËS ME BAZË GJINORE NË NIVEL PRODUKTI

4- PERFORMANCA E BUXHETIT NË NIVELIN E PROGRAMIT

4.1 Performanca Financiare e Programit Buxhetor

4.2 Performanca Jo Financiare e Programit Buxhetor

4.3 Veprimet vijuese në Nivelin e Programit Buxhetor

5- PROJEKTET KAPITALE

6- NDRYSHIMET NË BUXHET

7- PËRFUNDIME

1. HYRJJE

1.1 MISIONI

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka si mision hartimin e zbatimin e politikës së përgjithshme shtetërore në sektorin e planifikimit dhe të zhvillimit urban, në sektorin e infrastrukturës e të transportit, ujësjellës-kanalizimeve, në sektorin e telekomunikacionit dhe të shërbimit postar, në sektorin e energjisë, të shfrytëzimit të burimeve natyrore, si dhe në sektorin e industrisë minerare. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë është përgjegjëse për hartimin dhe ndjekjen e zbatimit të masave për eliminimin e pasojave dhe rindërtimin e objekteve të dëmtuara e të shkatërruara nga fatkeqësia natyrore, tërmeti i datës 26.11.2019.

1.2 FUSHAT E PËRGJEGJËSISË SHTETËRORE

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë e ushtron veprimtarinë e saj në zbatim të VKM-së nr.508 datë 25.09.2025 "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë".

1.3 PROGRAMET BUXHETORE

Në zbatim të ligjit 115/2024 "Për Buxhetin e vitit 2025" (të ndryshuar), MIE menaxhon 11 programe buxhetore si vijon:

1. Transporti Rrugor
2. Transporti Detar
3. Transporti Hekurudhor
4. Transporti Ajror
5. Furnizim me Ujë dhe Kanalizime
6. Mbështetje për Energjinë
7. Mbështetje për Burimet Natyrore
8. Mbështetje për Industrinë
9. Mbështetje për Rrjetet e Komunikacionit
10. Planifikim Urban
11. Planifikim Menaxhim Administrim

Në zbatim të ligjit 115/2024 "Për Buxhetin e vitit 2025", buxheti 2025 për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë është në vlerën 74,032,381,000 lekë, i detajuar sipas shpenzimeve:

- Shpenzime korrente 6,706,047,000 lekë
 - Shpenzime kapitale 67,326,334,000 lekë
- nga të cilat:*
- *shpenzime kapitale me finance të brendshëm* 53,508,305,000 lekë
 - *shpenzime kapitale me financim të huaj* 13,818,029,000 lekë

Plani i rishikuar i buxhetit për vitin 2025, për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, arriti në vlerën 74,546,991,610 lekë si vijon :

- Shpenzime korrente 8,075,267,610 lekë
 - Shpenzime kapitale 66,471,724,000 lekë
- nga të cilat :*
- *shpenzime kapitale me financim të brendshëm* 54,608,661,000 lekë
 - *shpenzime kapitale me financim të huaj* 11,863,063,000 lekë

Plani i shpenzimeve korrente pësoi ndryshime në nivel klasifikimi buxhetor, në kuadër të miratimit nga Ministria e Financave:

- ✓ Akordimi vjetor i fondit të veçantë në vlerën 5,865,610 lekë;
- ✓ Nga zbatimi i Aktit Normativ nr.10, datë 08.10.2025 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.115/2024 "Për buxhetin e vitit 2025"", tavani buxhetor u rrit me vlerën totale 132,250,000 lekë;
- ✓ Nga zbatimi i Aktit Normativ nr.11 datë 19.12.2025 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.115/2024 "Për buxhetin e vitit 2025"", tavani buxhetor u rrit me vlerën totale 1,231,105,000 lekë;

Plani i rishikuar i shpenzimeve kapitale me financim të brendshëm, pësoi ndryshime në nivel klasifikimi buxhetor në kuadër të miratimit nga Ministria e Financave:

- ✓ Nga zbatimi i Aktit Normativ nr.6, datë 11.06.2025 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.115/2024 "Për buxhetin e vitit 2025"", tavani buxhetor u pakësua me vlerën totale 4,972,850,000 lekë;
- ✓ Nga zbatimi i Aktit Normativ nr.10, datë 08.10.2025 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.115/2024 "Për buxhetin e vitit 2025"", tavani buxhetor u rrit me vlerën totale 6,000,000,000 lekë;
- ✓ Nga zbatimi i Aktit Normativ nr.11 datë 19.12.2025 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.115/2024 "Për buxhetin e vitit 2025"", tavani buxhetor u rrit me vlerën totale 23,206,000 lekë;
- ✓ Nga zbatimi i VKM nr.821, datë 30.12.2025 "Për një shtesë në VKM nr.684, datë 06.11.2024 "Për krijimin e shoqërisë aksionare Enti Kombëtar i Operimit Rrugor sh.a" u akordua fondi buxhetor shtesë vlerën totale 50,000,000 lekë;

Plani i rishikuar i shpenzimeve kapitale me financim të huaj, pësoi ndryshime në nivel klasifikimi buxhetor në kuadër të miratimit nga Ministria e Financave:

- ✓ Nga zbatimi i Aktit Normativ nr.11 datë 19.12.2025 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.115/2024 "Për buxhetin e vitit 2025"", tavani buxhetor u pakësua me vlerën totale 1,954,966,000 lekë;

Shtojmë në vëmendjen tuaj se :

Në zbatim të udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.14, datë 30.05.2023 "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e qeverisjes qendrore", sikurse ju kemi bërë me dije nëpërmjet email -it të datës 03 shkurt 2026, drejtuar suportit AFMIS në Ministrinë e Financave, procesi i gjenerimit të raporteve nga Moduli BPPM, Menaxhimi i Portofolit të Planifikimit Buxhetor, seksioni "Raporte dhe Aneke", nga sistemi AFMIS, nuk ka funksionuar në mënyrë të përsëritur.

Për këtë qëllim, procesi i raportit të monitorimit të zbatimit të buxhetit për vitin 2025, nga ekipet e menaxhimit të programeve buxhetore të MIE, është plotësuar në formë manuale me të dhënat buxhetore dhe realizimin faktik për vitin 2025, i gjeneruar nga Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë (SIFQ).

Theksojmë se, të dhënat buxhetore të realizimit financiar në Aneksin 1 të raportit vjetor të monitorimit të buxhetit për vitin 2025, duke e krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraardhës, rezulton se realizimi financiar për vitin 2024 është reflektuar me një rritje në vlerën 1,608,317 lekë.

Ky ndryshim i vlerës së Aneksit 1, vjen pas gjenerimit automatikisht të aneksit nga seksioni ‘‘Raporte dhe Aneksë’’, sistemi AFMIS, përpara mbylljes së afatit të rakordimeve apo sistemeve të mundshme të mbajtura nga njësitë e varësisë me degën e thesarit përkatës për vitin 2024.

Në mënyrë të specifikuar si vijon :

- Programin buxhetor ‘‘Planifikim, Menaxhim, Administrimi’’, me një vlerë shtesë 1,312,977 lekë;
- Programi buxhetor ‘‘Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime’’, me një vlerë shtesë 295,340 lekë;

Ndërsa, sipas klasifikimit buxhetor në nivel artikulli specifikohet si vijon :

- 602/ Mallra dhe shërbime të tjera, me një rritje vlere 1,473,977 lekë;
- 606 / Transferta për buxhete familjare dhe individë, me një ulje vlere 161,000 lekë;
- 230 / Kapitale të patrupëzuara, me një rritje vlere 295,340 lekë;

Në aneksin 1, të raportit vjetor të monitorimit të buxhetit për vitin 2025 janë reflektuar vlerat e sakta dhe të përditësuara nga sistemi për periudhën e vitit 2024.

2. INFORMACION BUXHETOR I AGREGUAR

Plani fillestar i buxhetit, plani i rishikuar dhe realizimi faktik për periudhën vjetore të vitit 2025, në nivel programi buxhetor, paraqitet në tabelën si më poshtë:

Emri i Grupit		Ministria e Infrastruktures dhe Energjise		Kodi i grupit	
EMËRTIME					
		Plani Fillestar Vjetor Viti 2025	Plani Vjetor i Rishikuar Viti 2025	Shpenzime Faktike të Periudhës/Progressive	% e realizimit
Shpenzimet sipas programeve buxhetore					
Kodi i Programit	Emërtimi				
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	753,244,000	1,280,190,725	1,258,421,512	98%
04320	Mbështetje per Energjinë	3,370,520,000	2,057,834,000	1,945,521,573	95%
04430	Mbështetje për Burimet Natyrore	446,605,000	446,133,915	432,911,094	97%
04440	Mbështetje për Industrinë	453,733,000	403,798,500	398,743,522	99%
04520	Transporti Rrugor	33,485,144,000	44,320,657,470	41,723,835,612	94%
04540	Transporti Detar	14,983,330,000	176,711,600	162,158,012	92%
04550	Transporti Hekurudhor	6,080,202,000	3,660,457,200	3,410,462,370	93%

04560	Transporti Ajror	27,550,000	7,031,684,000	7,031,226,013	100%
04610	Mbështetje për rrjetet e komunikacionit	70,000,000	0	0	0%
06180	Planifikimi Urban	201,973,000	139,152,000	121,472,838	87%
06370	Furnizimi me uje dhe kanalizime	14,160,080,000	15,030,372,200	15,315,725,960	102%
	Totali i Shpenzimeve buxhetore te Ministrise (Kap 01,02,03,04,05,08,22)	74,032,381,000	74,546,991,610	71,800,478,506	96%
	Shpenzime nga te Ardhurat Jashte limitit (Kap 06)	0 .00	0.00	73,943,268	
	Totali Shpenzimeve te Ministrisë	74,032,381,000	74,546,991,610	71,874,421,774	96%

Plani fillestar i buxhetit, plani i rishikuar dhe realizimi faktik për periudhën vjetore 2025, sipas klasifikimit ekonomik, paraqiten si në tabelën më poshtë:

në/lekë

Ministria e Infrastruktures dhe Energjise					
EMËRTIME					
		Plani Fillestar Vjetor Viti 2025	Plani Vjetor i Rishikuar Viti 2025	Shpenzime Faktike të Periudhës/Progresive	% e realizimit
Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik					
Artikulli	Emërtimi				
600	Paga	1,712,191,000	1,549,427,000	1,545,471,837	100%
601	Sigurime Shoqërore	295,383,000	255,065,000	253,271,414	99%
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	3,712,249,000	5,266,236,000	5,107,209,042	97%
603	Subvencione	850,000,000	850,000,000	850,000,000	100%
604	Transferta Korente të Brendshme	0	0	0	0%
605	Transferta Korente të Huaja	46,000,000	42,400,000	41,905,022	99%
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	90,224,000	112,139,610	110,725,519	99%
	Nen-Totali Shpenzime Korrente	6,706,047,000	8,075,267,610	7,908,582,835	98%
230	Kapitale të Patrupëzuara	701,809,000	848,532,621	832,291,156	98%
231	Kapitale të Trupëzuara	52,806,496,000	46,700,128,379	46,278,023,650	99%
232	Kapitale të Trupëzuara	0	7,060,000,000	7,060,000,000	100%
	Nen-Totali Shpenzime Kapitale me financim të brendshëm	53,508,305,000	54,608,661,000	54,170,314,806	99%
230	Kapitale të Patrupëzuara	140,000,000	79,634,000	42,971,406	
231	Kapitale të Trupëzuara	13,678,029,000	11,783,429,000	9,678,609,459	
	Nen-Totali Shpenzime Kapitale me financim te huaj	13,818,029,000	11,863,063,000	9,721,580,865	82%

	Totali Shpenzime Kapitale	67,326,334,000	66,471,724,000	63,891,895,671	96%
	Totali i Shpenz. Buxhetore të Ministrise/Institucionit Buxhetor	74,032,381,000	74,546,991,610	71,800,478,506	96%
	Shpenzime nga te Ardhurat Jashte limitit (Kap 06)	0	0	73,943,268	
	Totali i shpenzimeve (korrente, kapitale dhe te ardhurat jashte limitit)	74,032,381,000	74,546,991,610	71,874,421,774	96%

Për sa më lartë, rezulton se realizimi i fondeve buxhetore për vitin 2025 kundrejt planit të rishikuar të buxhetit 2025, **është 96%**.

Krahasuar me realizimin e fondeve buxhetore për të njëjtën periudhë të vitit 2024, e cila ishte në masën prej 93%, evidentohet një rritje e realizimit buxhetor **prej 3%**.

Në nivel klasifikimi buxhetor, të dhënat krahasuese të realizimit buxhetor në % midis dy periudhave janë

	vjetore 2024	vjetore 2025
✓ Shpenzimet korrente	98%	98%
✓ Shpenzime kapitale	92%	96 %
<i>nga të cilat :</i>		
○ Shpenzime kapitale me financim të brendshëm	99%	99%
○ Shpenzime kapitale me financim të huaj	63%	82%

Realizimi buxhetor i shpenzimeve korrente, ka nivel realizimi më të lartë në vlerë nominale dhe të njëjtë në %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2024.

në/000 lekë

Shpenzimet Korrente	vjetore 2024	vjetore 2025
✓ Plan vjetor i rishikuar	7,457,611	8,075,267
✓ Realizimi buxhetor	7,320,113	7,908,582

Realizimi buxhetor i shpenzimeve kapitale me financim të brendshëm ka nivel realizimi më të lartë në vlerë nominale dhe të njëjtë në %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2024.

në / 000 lekë

Shpenzimet Kapitale FB	vjetore 2024	vjetore 2025
✓ Plan vjetor i rishikuar	47,771,510	54,608,661
✓ Realizimi buxhetor	47,283,320	54,170,315

Realizimi buxhetor i shpenzimeve kapitale me financim të huaj ka rritje në nivel realizimi më të lartë si në vlerë nominale ashtu dhe në %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2024.

në / 000 lekë

Shpenzimet Kapitale FF	vjetore 2024	vjetore 2025
✓ Plan vjetor i rishikuar	12,097,902	11,863,063
✓ Realizimi buxhetor	7,644,196	9,721,580

Lidhur me rialokimet buxhetore për vitin 2025, në nivel klasifikimi buxhetor japim shpjegimet si vijon:

- Për shpenzimet korrente janë kërkuar nga MIE dhe janë miratuar nga MF, 8 procedura buxhetore:
 - 5 procedura miratimi për akordim shtesë e fondit të veçantë;
 - 3 procedura miratimi për transferime fondesh sipas njësive shpenzuese;
- Për shpenzimet kapitale me financim të brendshëm janë kërkuar nga MIE dhe janë miratuar nga MF, 2 procedura buxhetore:
 - 1 procedurë miratimi për programin "Furnizimi me Uje dhe Kanalizime";
 - 1 procedurë miratimi për programin "Transporti Rrugor";
- Për shpenzimet kapitale me financim të huaj janë kërkuar nga MIE dhe janë miratuar nga MF, 1 procedurë buxhetore:
 - 1 procedurë miratimi për programin "Transporti Detar";

Në zbatim të ligjit 115/2024 "Për Buxhetin e vitit 2025" (të ndryshuar), numri maksimal i punonjësve i miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë është 1338 punonjës dhe numri faktik 1192 punonjës.

Në tabelën më poshtë paraqiten numri i punonjësve të shpërndarë në organikat e njësive shpenzuese të varësisë si dhe numri i punonjësve të pashpërndarë për organikat e reja të pazbardhura, por të miratuara me ligjet përkatëse.

Entiteti i Qeverisjes	Ministria e Linjës	Kod Institucioni	Emer Institucioni	Numri i punonjësve buxhetore i miratuar për vitin 2025	Numri Faktik i punonjësve buxhetore sipas njësive shpenzuese
001	06	1006001	Aparati MIE	248	211
001	06	1006054	Autoriteti Rrugor Shqiptar	212	138
001	06	1006067	Drejtoria e Rajonit Jugor (Gjirokastrë)	41	41
001	06	1006077	Drejtoria e Rajonit Verior (Shkodër)	47	46
001	06	1006079	Drejtoria e Rajonit Qender Perendim (Tiranë)	41	41
001	06	1006200	Drejtoria e Rajonit Qender Lindje (Korçë)	45	44
001	06	1006099	Instituti Transportit	15	14
001	06	1006100	Autoriteti Sigurisë Hekurudhore	15	6
001	06	1006205	Autoriteti Rregullator Hekurudhor	6	1
001	06	1006098	Drejtoria e Përgjithshme Detare	70	68
001	06	1006143	Autoriteti Kombëtar i Investigimit për Sigurinë e Operimit në Aviacionin Civil	8	8
001	06	1006047	Agjencia Kombëtare e Ujësjetës Kanalizimeve	97	97
001	06	1006155	Agjencia Kombëtare Bërthamore	7	7
001	06	1006164	Agjencia e Eficiencës së Energjisë	20	19

001	06	1006156	Shërbimi Gjeologjik Shqiptar	116	108
001	06	1006158	Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera	47	43
001	06	1006203	Qendra Rajonale Inovacionit të Institucionit Evropian të Teknologjisë dhe Inovacionit për Lendet e para	8	8
001	06	1006157	Inspektoriati Shtetëror Teknik Industrial	199	199
001	06	1006159	Qendra e Grumbullimit, Trajtimit të Kimikateve të Rrezikshme	13	11
001	06	1006161	Arkivi Qëndror Teknik i Ndërtimit	21	21
001	06	1006187	Agjensia Shtetërore e Shpronësimeve	27	26
			Numri i pa shpërndarë	35	35
			TOTALI	1338	1192

3. PERFORMANCA E TREGUESVE KYÇ TË PËRFORMANCËS ME BAZË GJINORE NË NIVEL PRODUKTI

Objekti i politikës së programit "Planifikimim, Menaxhim, Administrim", është mirëmenaxhimi i stafit të Aparatit MIE dhe politikëbërja me sukses brenda fushës së përgjegjësi shtetërore, duke respektuar parimin e barazisë gjinore dhe mos diskriminimin. Treguesit më kryesor të performancës me bazë gjinore renditen:

- ✓ Forcimi kapaciteteve administrative nëpërmjet trajnimeve të ndryshme për punonjësit e administratës 55%
- ✓ Gra të përfaqësuara në nivele të larta drejtuese të Aparatit të MIE 4
- ✓ Raporti gra/ndaj totalit të punonjësve të Aparatit të MIE 145
- ✓ Raporti burra/ndaj totalit të punonjësve të Aparatit të MIE 66

Programi "Mbështetje për Rrjetet e Komunikacionit", përfshin si tregues të performancës rritjen e penetrimit dhe përdorimit të infrastrukturës digjitale broadband që i shërben përfshirjes sociale dhe barazisë gjinore.

Në veçanti, projekti i parashikuar për investime në fibrat optike në zonat e bardha, parashikon të mbulojë me shërbime dhe infrastrukturë digjitale, zonat e pambuluara/pa shërbyera nga sektori privat duke rritur potencialisht mundësinë e përfshirjes sociale, të punësimit, dhe zvogëlimin të ndarjes digjitale gjinore. Gjithashtu projekti i parashikuar për sigurimin e mbulimit me Ëi-Fi në zonat publike i shërben lehtësimit të aksesimit në TIK dhe shërbimet publike për të gjithë banorët/qytetarët në zonat e thella.

Referuar të dhënave më të fundit statistikore, shkalla e përdorimit të TIK, dhe në veçanti e Internetit në vend është si më poshtë:

- Përdorues të Internetit - Gjatë vitit 2025, 88% e burrave dhe 86% e grave të grup-moshës 16-74 vjeç janë përdorues të internetit.

- Shpeshtësia e përdorimit të internetit sipas ndarjes gjinore, tregon se përdorimi i internetit “disa herë gjatë ditës” dominohet nga burrat me 50%, ndërsa përdorimi i tij “çdo ditë” dominohet nga gratë me 53 %.¹
- Të punësuar në sektorin e telekomunikacionit - ndarja sipas gjinisë për të punësuarit në sektorin e telekomunikacionit ishte 31% gra dhe 69% burra. Gjatë periudhës së monitorimit të dhënat me bazë vjetore janë të raportuara nga INSTAT dhe ITU.

4. PERFORMANCA E BUXHETIT NË NIVELIN E PROGRAMIT

4.1 PERFORMANCA FINANCIARE E PROGRAMIT BUXHETOR

4.1.1 Programi Buxhetor "Planifikim Menaxhim Administrim"

Realizimi financiar i programit buxhetor "Planifikim Menaxhim Administrim" sipas burimit të financimit dhe në nivel klasifikimi buxhetor rezulton të jetë:

	Plani fillestar 2025	Plani rishikuar 2025	Realizimi në lekë	Realizimi në%
Shpenzime korrente	753,244,000	1,280,190,725	1,258,421,512	99%
Shpenzime kapitale FB	13,000,000	9,000,000	0	0%
Shpenzime kapitale FH	0	0	0	0%

Në shpenzimet korrente të programit, plani i rishikuar i vitit 2025 ka një rritje prej 530,946,725 lekë, që vjen nga:

- Akordimi i fondit të veçantë në vlerën 1,196,725 lekë, ku për periudhën raportuese në sasi produkti janë realizuar pesë raste dalje në pension, një rast për ndihmë mjekësore dhe tre raste për ndihmë fatkeqësie.
- Nga zbatimi i Aktit normativ nr.11, datë 19.12.2025 "Për buxhetin e vitit 2025" (të ndryshuar), në vlerën 529,750,000 lekë, ku:
Shpenzimet për paga u pakësuan 950,000 lekë;
Shpenzimet për sigurimet shoqërore e shëndetsore, u pakësuan 700,000 lekë;
Shpenzimet për transfertat korrente të huaja u pakësuan 4,600,000 lekë;
Shpenzimet për vendime gjyqësore të formës së prerë u shtuan 520,000,000 lekë;
Shpenzimet për transfertat për buxhetet familjare dhe individët, u shtuan 16,000,000 lekë;

Në shpenzimet kapitale të programit plani i rishikuar për vitin 2025, nuk ka realizim në produkte dhe në financim, pasi me Aktin Normativ nr.11, datë 19.12.2025 "Për disa shtesa dhe ndryshime në buxhetin e vitit 2025", plani u pakësua me vlerën 4,000,000 lekë.

në / 000 lekë

Shpenzimet Kapitale FB	Realizimi Financiar Viti 2024	Realizimi Financiar Viti 2025
Artikulli 231	16,312	0
REALIZIMI NË%	93%	0%

Shpenzimet korrente në program shërbëjnë për mirëfunksionimin e aktivitetit operacional të Aparati i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, të realizuara me numër faktik prej 211 punonjës.

Për zërin e transfertave korrente të huaja janë realizuar pagesa për 9 organizata ndërkombëtare ndërsa për transfertat për buxhetin familjar dhe individë janë realizuar pagesa për 1314 dosje rimbursimi të shpenzimeve të varrimit për shtetasit shqiptarë që vdesin jashtë vendit.

Si më poshtë vijon, paraqiten të dhënat krahasuese për realizimin financiar për të njëjtën periudhë të vitit 2024. Rezulton se për vitin 2025, ka një realizim më të ulët ndaj planit vjetor në vlerë nominale dhe më të lartë në %.

në / 000 lekë

Shpenzimet Korrente	Realizimi Financiar Viti 2024	Realizimi Financiar Viti 2025
Artikulli 600	333,699,	353,608
Artikulli 601	53,116	57,051
Artikulli 602	754,722	700,282
Artikulli 605	41,294	40,317
Artikulli 606	99,891	107,163
TOTALI	1,282,722	1,258,422
REALIZIMI NË%	98%	99%

4.1.2 Programi Buxhetor "Planifikimi Urban"

Realizimi financiar i programit buxhetor "Planifikimi Urban", sipas burimit të financimit dhe në nivel klasifikimi buxhetor rezulton të jetë:

	Plani fillestar 2025	Plani rishikuar 2025	Realizimi në lekë	Realizimi në%
Shpenzime korrente	97,973,000	87,094,000	82,390,024	95%
Shpenzime kapitale FB	104,000,000	52,058,000	39,082,814	75%
Shpenzime kapitale FH	0	0	0	0%

Në shpenzimet korrente të programit, plani i rishikuar i vitit 2025 ka pësuar ndryshime si vijon :

- Nga akordimi i fondit të veçantë në vlerën 71,000 lekë dhe është financuar në vlerën 58,080 lekë për një rast dalje në pension.
- Nga zbatimi i Aktit Normativ nr.11, datë 19.12.2025 "Për disa shtesa dhe ndryshime në buxhetin e vitit 2025", plani u pakësua me vlerën 10,950,000 lekë

Në shpenzimet kapitale me financim të brendshëm, plani i rishikuar i vitit 2025 është pakësuar me vlerën 51,942,000 lekë, si vijon:

- Në kuadër të Aktit Normativ nr.6, datë 11.06.2025 "Për disa shtesa dhe ndryshime për buxhetin e vitit 2025", është miratuar transferimi i fondit buxhetor në vlerën 500,000 lekë nga Ministria e Financave.
- Nga zbatimi i Aktit Normativ nr.11, datë 19.12.2025 "Për disa shtesa dhe ndryshime në buxhetin e vitit 2025", plani u pakësua me vlerën 51,942,000 lekë.

Si më poshtë vijon, paraqiten të dhënat krahasuese për realizimin financiar për të njëjtën periudhë të vitit 2024. Rezulton se për vitin 2025 ka një realizim më të lartë si në vlerë nominale, ashtu dhe në %.

në /000 lekë

Shpenzimet Korrente	Realizimi Financiar Viti 2024	Realizimi Financiar Viti 2025
Artikulli 600	52,602	59,542
Artikulli 601	8,641	9,800
Artikulli 602	14,851	12,962
Artikulli 605	0	0
Artikulli 606	296	86
TOTALI	76,390	82,390
REALIZIMI NË%	90%	95%

Shpenzimet korrente në program shërbëjnë për mirëfunksionimin e aktivitetit operacional të dy institucioneve të varësisë:

- ✓ Arkivi Qëndror Teknik i Ndërtimit, në sasi produkti me numër faktik 21 punonjës;
- ✓ Agjencia Shtetërore e Shpronësimeve, në sasi produkti me numër faktik 26 punonjës;

Realizimi i shpenzimeve kapitale të programit, rezulton se për vitin 2025 ka një realizim më të lartë si në vlerë nominale, ashtu dhe në % krahasuar me të njëjtën periudhën krahasuese të vitit 2024.

Shpenzimet Kapitale FB	Realizimi Financiar Viti 2024	Realizimi Financiar Viti 2025
Artikulli 230	0	0
Artikulli 231	26,274	39,083
TOTALI	26,274	39,083
REALIZIMI NË%	61%	75%

Shpenzimet kapitale të programit realizohen nga dy njësi shpenzuese të varësisë dhe dy Bashki si vijon:

- ✓ Arkivi Qendror Teknik i Ndërtimit, me plan të shpenzimeve kapitale prej 7.2 milion lekë dhe realizimi financiar prej 2.2 milion për implementimin e 1 projekti;
- ✓ Agjencia Shtetërore e Shpronësimeve, me plan të shpenzimeve kapitale prej 8.4 milion lekë dhe realizim financiar prej 475 mijë lekë për implementimin e 1 projekti. Për 2 projektet e tjerë procedurat e prokurimit nuk u realizuan në kohë nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit.
- ✓ Bashkia Fier, me plan dhe realizim të shpenzimeve në vlerën 2.4 milion lekë, për zërin shpronësime në zbatim të VKM nr.125, datë 03.03.2021.
- ✓ Bashkia Vlorë, me plan dhe realizim të shpenzimeve në 33.9 milion lekë për zërin shpronësime në zbatim të VKM nr.504, datë 25.08.2021.

4.1.3 Programi Buxhetor "Mbështetje për Rrjetet e Komunikacionit"

Realizimi financiar i programit buxhetor "Mbështetje për Rrjetet e Komunikacionit", sipas burimit të financimit dhe në nivel klasifikimi buxhetor rezulton të jetë:

	Plani fillestar 2025	Plani rishikuar 2025	Realizimi në lekë	Realizimi në%
Shpenzime korrente	0	0	0	0%
Shpenzime kapitale FB	50,000,000	0	0	0%
Shpenzime kapitale FH	20,000,000	0	0	0%

Në shpenzimet kapitale me financim të brendshëm të programit, plani i rishikuar 2025, është si vijon :

- Nga zbatim të Aktit Normativ nr.10, datë 08.10.2025 "Për disa shtesa dhe ndryshime ne buxhetin e vitit 2025" plani u pakësua në vlerën 45.000.000 lekë;
- Nga zbatimi i Aktit Normativ nr.11, datë 19.12.2025 "Për disa shtesa dhe ndryshime në buxhetin e vitit 2025" plani u pakësua me 5,000,000 lekë;

Në shpenzimet kapitale me financim të huaj të programit, plani i rishikuar 2025, është si vijon :

- Nga zbatimi i Aktit Normativ nr.11, datë 19.12.2025 "Për disa shtesa dhe ndryshime në buxhetin e vitit 2025" (të ndryshuar), plani u pakësua me vlerën 20,000,000 lekë;

Projektet kapitale paraqiten si më poshtë:

Gjatë vitit 2025 programi buxhetor "Mbështetje për Rrjetet e Komunikacionit" për shpenzimet kapitale me financim të brendshëm dhe për shpenzimet kapitale me financim të huaj nuk kanë pasur realizim produkti dhe realizim financiar për periudhën e raportimit si vijon :

Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm:

- Investime në fibër optike në zonat e bardha, projekti nuk u realizua pasi pritet përfundimi i projektit të asistencës teknike, kur për këtë në WBIF është aplikuar për grant investimi i cili pritet të përfundojë në muajin shkurt 2026.
- Zhvillimi i marrëveshjes Shqipëri-Kosovë mbi Autostradën Digjitale 5G Prishtinë-Tiranë, nuk u realizua pasi investimi nuk ka filluar ende.
- Zbatimi i kuadrit të ri ligjor për komunikimet elektronike nuk u realizua, pasi me implementimin e ligjit të ri të komunikimeve elektronike, lind nevoja e draftimit të akteve nën ligjore që rrjedhin prej tij. Është miratuar VKM nr.504 datë 01.08.2024 "Për përcaktimin e karakteristikave teknike për antenat në zonat e vogla" si dhe VKM nr.756 datë 23.12.2024 "Për miratimin e Planit Kombëtar të Frekuencave" dhe për projektaktet e tjera në kuadër të programit IPA III, e cila është në proces vlerësimi të ofertave dhe si e tillë nuk ka filluar ende. Aktualisht është duke u punuar me hartimin e akteve të cilat priten të finalizohen brenda vitit 2026.
- WiFi4AL, projekti nuk ka filluar ende, pasi po koordinohet me projektin rajonal EU4Digital të financuar nga BE për Ballkanin Perëndimor dhe implementohet nga GIZ i cili ka zhvilluar tenderin për 6 vendet dhe ka shpallur kompaninë fituese për implementimin e këtij projekti në Shqipëri për krijimin e Free-WiFi.
- Programi Digjital i BE-së nuk u realizua gjatë vitit 2025, pasi MIE dhe AKSHI kanë bashkëpunuar për organizimin e aktiviteteve informuese si dhe publikimin e njoftimeve për projektet dhe thirrjet e hapura nën programin DEP. Aktualisht është në proces përgatitja e planit të komunikimit i cili do të vijojë në vitin 2026.

Shpenzimet kapitale me financim të huaj:

- Investime në fibër optike në zonat e bardha nuk u realizua, pasi në WBIF u aplikua për një grant investimi në thirrjen e muajit qershor 2025, vendimi i cili pritet të finalizohet në muajin shkurt 2026.

4.1.4 Programi Buxhetor "Transporti Ajror"

Realizimi financiar i programit buxhetor "Transporti Ajror", sipas burimit të financimit dhe në nivel klasifikimi buxhetor rezulton të jetë:

	Plani fillestar 2025	Plani rishikuar 2025	Realizimi në lekë	Realizimi në%
Shpenzime korrente	25,550,000	29,726,000	29,538,413	99%
Shpenzime kapitale FB	2,000,000	7,001,958,000	7,001,687,600	100%
Shpenzime kapitale FH	0	0	0	0%

Në shpenzimet korrente të programit, plani i vitit 2025, ka pësuar rritje në vlerën 4,176,000 lekë si vijon:

- Akordim i fondit të veçantë në vlerën 156,000 lekë dhe nuk ka pasur realizim financiar;
- Nga zbatimi i Aktit Normativ nr.10, datë 08.10.2025 "Për disa shtesa dhe ndryshime në buxhetin e vitit 2025", plani u shtuan me vlerën 4,000,000 lekë;
- Nga zbatimi i Aktit Normativ nr.11, datë 19.12.2025 "Për disa shtesa dhe ndryshime në buxhetin e vitit 2025, plani u shtua me vlerën 20,000 lekë;

Në shpenzimet kapitale me financim të brendshëm të programit plani i rishikuar ka pësuar rritje në vlerën 6,999,958,000 lekë, nga ndryshimet buxhetore si vijon :

- Nga zbatimi i Aktit Normativ nr.10, datë 08.10.2025 "Për disa shtesa dhe ndryshime në buxhetin e vitit 2025", plani u shtua me vlerën 3,000,000,000 lekë;
- Nga zbatimi i Aktit Normativ nr.11, datë 19.12.2025 "Për disa shtesa dhe ndryshime në buxhetin e vitit 2025", plani u shtua me vlerën 4,000,000,000 lekë;
- Nga zbatimi i Aktit Normativ nr.11, datë 19.12.2025 "Për disa shtesa dhe ndryshime në buxhetin e vitit 2025", plani u pakësua me vlerën 42,000 lekë;

Si më poshtë vijon, përcjellim të dhënat krahasuese për realizimin financiar për të njëjtën periudhë të vitit 2024. Rezulton se për vitin 2025, ka një realizim më të ulët si në vlerë nominale ashtu edhe në %.

	Realizimi Financiar Viti 2024	Realizimi Financiar Viti 2025
<i>në / 000 lekë</i>		
Shpenzimet Korrente		
Artikulli 600	13,303	13,610
Artikulli 601	2,168	2,200
Artikulli 602	14,802	13,680
Artikulli 605	0	0
Artikulli 606	76	48
TOTALI	30,349	29,538
REALIZIMI NË%	100%	99%

Shpenzimet korrente në program shërbëjnë për mirëfunksionimin e aktivitetit operacional të Autoritetit Kombëtar të Investigimit për Sigurinë e Operimit në Aviacionin Civil me numër faktik 8 punonjës.

Si më poshtë vijon, përcjellim të dhënat krahasuese për realizimin financiar për të njëjtën periudhë të vitit 2024. Rezulton se për vitin 2025, ka një realizim më të lartë në vlerë nominale dhe të njëjtë në %.

	Realizimi Financiar Viti 2024	Realizimi Financiar Viti 2025
<i>në /000 lekë</i>		
Shpenzimet Kapitale FB		
Artikulli 230	0	0
Artikulli 231	1,887	1,688

Artikulli 232	0	7,000,000
TOTALI	1,887	7,001,688
REALIZIMI NË%	100%	100%

Në shpenzimet kapitale me financim të brendshëm të programit, për periudhën raportuese ka pasur realizim financiar në 3 produkte, si vijon:

- Projekti "Blerje çanta e investigatorit në detyrë" (sipas aneksit 13, te ICAO), planifikuar në vlerën 1,000,000 lekë dhe realizuar në vlerën 730,000 lekë ose në masën 73%.
- Projekti "Blerje paisje investiguese" planifikuar në vlerën 958,000 lekë dhe realizuar në vlerën 957,600 lekë ose në masën 100%.
- Mbështetje buxhetore për veprimtarinë e Albcontrol, akorduar plan dhe realizim financiar në vlerën 7,000,000,000 lekë ose në masën 100%.

4.1.5 Programi Buxhetor "Mbështetje për Industrinë"

Realizimi financiar i programit buxhetor "Mbështetje për Industrinë", sipas burimit të financimit dhe në nivel klasifikimi buxhetor rezulton të jetë:

	Plani fillestar 2025	Plani rishikuar 2025	Realizimi në lekë	Realizimi në%
Shpenzime korrente	375,733,000	385,048,500	379,993,522	99%
Shpenzime kapitale FB	78,000,000	18,750,000	18,750,000	100 %
Shpenzime kapitale FH	0	0	0	0 %

Në shpenzimet korrente të programit, plani i rishikuar 2025 ka një rritje prej 9,315,500 lekë që vjen nga:

- Akordimi i fondit të veçantë në vlerën 9,315,500 lekë, dy raste dalje në pension dhe dy raste dhënie ndihmë fatkeqësie;
- Nga zbatimi i Aktit Normativ nr.10, datë 08.10.2025 "Për disa shtesa dhe ndryshime në buxhetin e vitit 2025" plani u shtua me vlerën 39,400,000 lekë;
- Nga zbatimi i Aktit Normativ nr.11, datë 19.12.2025 "Për disa shtesa dhe ndryshime në buxhetin e vitit 2025", plani u shtua me vlerën 30,377,000 lekë;

Në shpenzimet kapitale me financim të brendshëm të programit, plani i rishikuar 2025 është pakësuar me vlerën 59,250,000 lekë që vjen nga:

- Nga zbatimi i Aktit Normativ nr.6, date 11.06.2025 "Për disa shtesa dhe ndryshime në buxhetin e vitit 2025" plani u pakësua me vlerën 57,850,000 lekë;
- Nga zbatimi i Aktit Normativ nr.10, datë 08.10.2025 "Për disa shtesa dhe ndryshime në buxhetin e vitit 2025" plani u shtua me vlerën 5,000,000 lekë;
- Nga zbatimi i Aktit Normativ nr.11, datë 19.12.2025 "Për disa shtesa dhe ndryshime në buxhetin e vitit 2025", plani u pakësua me vlerën 6,400,000 lekë;

Si më poshtë vijon, përcjellim të dhënat krahasuese për realizimin financiar për të njëjtën periudhë të vitit 2024. Rezulton se për vitin 2025, ka një realizim më të ulët në vlerë nominale dhe të njëjtë në %.

në / 000 lekë

Shpenzimet Korrente	Realizimi Financiar Viti 2024	Realizimi Financiar Viti 2025
Artikulli 600	270,641	282,667
Artikulli 601	44,927	46,974

Artikulli 602	74,301	50,060
Artikulli 605	0	0
Artikulli 606	845	293
TOTALI	390,714	379,994
REALIZIMI NË %	99 %	99%

Shpenzimet korrente në program shërbëjnë për mirëfunksionimin e aktivitetit operacional të dy institucioneve të varësisë:

- ✓ Inspektoriati Shtetëror Teknik Industrial, në sasi produkti me numër faktik 199 punonjës;
- ✓ Qendra e Grumbullimit, Trajtimit të Kimikateve të Rrezikshme, në sasi produkti me numër faktik 11 punonjës;

Realizimi i shpenzimeve kapitale të programit rezulton se për vitin 2025 ka një realizim më të ulët në vlerë nominale dhe më të lartë në %, me të njëjtën periudhë krahasuese të vitit 2024.

Shpenzimet Kapitale FB	Realizimi Financiar	Realizimi Financiar
	Viti 2024	Viti 2025
Artikulli 231	45,540	18,750
REALIZIMI NË %	62%	100%

Shpenzimet kapitale të programit janë realizuar nga 2 njësi shpenzuese të programit si vijon.

- ✓ Uzina e Plehrave Azotike me një plan dhe realizim faktik të shpenzimeve kapitale prej 8.7 milion lekë fonde konservimi dhe ruajtjen e monitorimin e 2 landfilleve të mbetjeve të rrezikshme;
- ✓ Ndërmarrja e Prodhim Celiqueve Elbasan, me një plan dhe realizim faktik të shpenzimeve kapitale prej 10 milion lekë për fonde konservimi.

4.1.6 Programi Buxhetor "Mbështetje për Burimet Natyrore"

Realizimi financiar i programit buxhetor "Mbështetje për Burimet Natyrore", sipas burimit të financimit dhe në nivel klasifikimi buxhetor rezulton të jetë:

	Plani fillestar 2025	Plani rishikuar 2025	Realizimi në lekë	Realizimi në%
Shpenzime korrente	349,605,000	306,727,915	299,554,835	98%
Shpenzime kapitale FB	97,000,000	139,406,000	133,356,259	96%
Shpenzime kapitale FH	0	0	0	0%

Në shpenzimet korrente të programit, plani i rishikuar 2025 ka një rritje prej 42,877,085 lekë që vjen nga:

- Akordimi i fondit të veçantë në vlerën 1,565,915 lekë, ku është realizuar për dhjetë raste dalje në pension, tre raste dhënie ndihmë për fatkeqësi dhe tre raste për ndihmë për ndërhyrje shëndetsore.
- Nga zbatimi i Aktit Normativ nr.11, datë 19.12.2025 "Për disa shtesa dhe ndryshime në buxhetin e vitit 2025" plani pakësohet me vlerën 44,443,000 lekë.

Në shpenzimet kapitale me financim të brendshëm të programit, plani i rishikuar 2025 është pakësuar me vlerën 42,406,000 lekë që vjen nga:

- Nga zbatimi i Aktit Normativ nr.10, datë 08.10.2025 "Për disa shtesa dhe ndryshime në buxhetin e vitit 2025" plani u shtua me vlerën 44,000,000 lekë;
- Nga zbatimi i Aktit Normativ nr.11, datë 19.12.2025 "Për disa shtesa dhe ndryshime në buxhetin e vitit 2025", plani u pakësua me vlerën 1,594,000 lekë;

Si më poshtë vijon, përcjellim të dhënat krahasuese për realizimin financiar për të njëjtën periudhë të vitit 2024. Rezulton se për vitin 2025, ka një realizim më të lartë si në vlerë nominale ashtu edhe në %:

në / 000 lekë

Shpenzimet Korrente	Realizimi Financiar Viti 2024	Realizimi Financiar Viti 2025
Artikulli 600	181,155	215,614
Artikulli 601	28,952	34,739
Artikulli 602	39,343	46,035
Artikulli 605	785	1,588
Artikulli 606	1,809	1,579
TOTALI	252,044	299,555
REALIZIMI NË%	94%	98%

Shpenzimet korrente në program shërbëjnë për aktivitetin operacional të tre institucioneve të varësisë:

- ✓ Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, me numër faktik 108 punonjës;
- ✓ Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera, me numër faktik 43 punonjës;
- ✓ Qendra Rajonale e Inovacionit të Institutit Evropian të Teknologjisë dhe Inovacionit të Lëndëve të para, me numër faktik 8 punonjës.

Si më poshtë vijon, përcjellim të dhënat krahasuese për realizimin financiar të shpenzimeve kapitale krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2024. Rezulton se për vitin 2025, ka një realizim më të ulët në vlerë nominale dhe më të lartë në %.

në / 000 lekë

Shpenzimet Kapitale FB	Realizimi Financiar Viti 2024	Realizimi Financiar Viti 2025
Artikulli 230	84,799	85,651
Artikulli 231	92,769	47,701
TOTALI	177,568	133,356
REALIZIMI NË%	93%	96%

Shpenzimet kapitale të programit janë realizuar nga 6 njësi shpenzuese të programit si vijon:

- ✓ Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, me plan dhe realizim të shpenzimeve kapitale prej 68.1 milion lekë për implementimin e 7 projekteve;
- ✓ Sekretariati i Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse - EITI, me plan 18.6 milion lekë dhe realizim të shpenzimeve kapitale prej 17.5 milion lekë për funksionimin e saj;
- ✓ Autoriteti Kombëtar i Sigurisë së Emergjencave në Miniera, me plan 11.9 milion lekë dhe realizim financiar 10.9 milion lekë për implementimin e 1 projekti;
- ✓ Shoqëria në konservim “Albakër” sh.a. me plan dhe realizim faktik të shpenzimeve kapitale 12.6 milion lekë për fonde konservimi;
- ✓ Shoqëria në konservim “Albminiera” sh.a. me plan dhe realizim faktik të shpenzimeve kapitale 12.2 milion lekë për fonde konservimi;
- ✓ Shoqëria në konservim “Albkrom” sh.a. me plan dhe realizim faktik të shpenzimeve kapitale prej 12 milion lekë për fonde konservimi;

Në shpenzimet kapitale me financim të huaj të programit, plani i rishikuar 2025 është pakësuar nga:

- Nga zbatimi i Aktit Normativ nr.10, datë 08.10.2025 "Për disa shtesa dhe ndryshime në buxhetin e vitit 2025" plani u shtua me vlerën 16,800,000 lekë;

- Nga zbatimi i Aktit Normativ nr.11, datë 19.12.2025 "Për disa shtesa dhe ndryshime në buxhetin e vitit 2025", plani u pakësua me vlerën 16,800,000 lekë;

4.1.7 Programi Buxhetor "Transporti Detar"

Realizimi financiar i programit buxhetor "Transporti Detar", sipas burimit të financimit dhe në nivel klasifikimi buxhetor rezulton të jetë:

	Plani fillestar 2025	Plani rishikuar 2025	Realizimi në lekë	Realizimi në %
Shpenzime korrente	178,330,000	144,153,600	142,519,077	99%
Shpenzime kapitale FB	14,795,000,000	27,224,000	15,893,408	58%
Shpenzime kapitale FH	10,000,000	5,334,000	3,745,528	70%

Në shpenzimet korrente të programit, plani i rishikuar 2025 është pakësuar me vlerën 34,176,400 lekë që vjen nga:

- Akordimi i fondit të veçantë, në vlerën 173,600 lekë, për një rast dalje në pension dhe për një rast ndihmë mjekësore.
- Nga zbatim të Aktit Normativ nr.11, datë 19.12.2025 "Për disa ndryshime në ligjin e buxhetit të vitit 2025", plani u pakësua me vlerën 34,350,000 lekë.

Në shpenzimeve kapitale me financim të brendshëm të programit, plani i rishikuar 2025 është pakësuar me fondin 14,767,776,000 lekë që vjen nga:

- Nga zbatimi i Aktit Normativ nr.6, datë 11.06.2025 "Për disa ndryshime në ligjin e buxhetit të vitit 2025", plani u pakësua me 4,915,000,000 lekë.
- Nga zbatimi i Aktit Normativ nr.11, datë 19.12.2025 "Për disa ndryshime në ligjin e buxhetit të vitit 2025", plani u pakësua me 9,852,776,000 lekë.

Plani i rishikuar i vitit 2025 për shpenzimet kapitale me financim të huaj është pakësuar me vlerën 4,666,000 lekë që vjen nga:

- Nga zbatimi i Aktit Normativ nr.11, datë 19.12.2025 "Për disa ndryshime në ligjin e buxhetit të vitit 2025", plani u pakësua me vlerën 4,666,000 lekë.

Si më poshtë vijon, paraqiten të dhënat krahasuese për realizimin financiar për të njëjtën periudhë të vitit 2024. Rezulton se për vitin 2025, ka një realizim me të lartë si në vlerë nominale ashtu dhe në %.

në / 000 lekë

Shpenzimet Korrente	Realizimi Financiar Viti 2024	Realizimi Financiar Viti 2025
Artikulli 600	101,410	108,611
Artikulli 601	16,745	18,035
Artikulli 602	12,640	15,699
Artikulli 605	0	0
Artikulli 606	399	173
TOTALI	131,194	142,519
REALIZIMI NË%	91%	99%

Shpenzimet korrente në program shërbëjnë për mirëfunksionimin e aktivitetit operacional të Drejtorisë së Përgjithshme Detare, me një administratë funksionale me numër faktik prej 68 punonjesh.

Si më poshtë vijon, paraqiten të dhënat krahasuese për realizimin financiar për të njëjtën periudhë të vitit 2024. Rezulton se për vitin 2025, ka një realizim me të lartë si në vlerë nominale ashtu dhe në %.

në / 000 lekë

Shpenzimet Kapitale FB	Realizimi Financiar Viti 2024	Realizimi Financiar Viti 2025
Artikulli 230	3,232	0
Artikulli 231	10,850	15,894
TOTALI	14,082	15,894
REALIZIMI NË%	41%	58%

Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm të programit janë realizuar nga 3 njësi shpenzuese të varësisë si vijon:

- ✓ Drejtoria e Përgjithshme Detare Durrës, me plan të shpenzimeve kapitale prej 22.9 milion lekë dhe realizim faktik 11.6 milion lekë për implementimin e 3 projekteve;
- ✓ Autoriteti Portual Durrës, fondet buxhetore u pakësuan pasi procedurat e prokurimit dhe të vlerësimit të dokumentacionit ligjor teknik do të perfundojnë në vitin 2026.
- ✓ Ndërmarrja e Shfrytëzimit Ujor Vau Dejës, me plan të shpenzimeve kapitale prej 4.3 milion lekë dhe realizim faktik në vlerën 4.2 milion lekë për fonde konservimi;

Si më poshtë vijon, paraqiten të dhënat krahasuese për realizimin financiar të shpenzimeve kapitale me financim të huaj për të njëjtën periudhë të vitit 2024. Rezulton se për vitin 2025, ka një realizim me të ulët në vlerë nominale dhe të lartë në %.

në / 000 lekë

Shpenzimet Kapitale FH	Realizimi Financiar Viti 2024	Realizimi Financiar Viti 2025
Artikulli 230	4,256	0
Artikulli 231	0	3,745
TOTALI	4,256	3,745
REALIZIMI NË%	50%	70%

Shpenzimet kapitale me financim të huaj të programit realizohen nga njësi shpenzuese e varësisë

- ✓ Drejtoria e Përgjithshme Detare Durrës, me plan të shpenzimeve kapitale prej 5.3 milion lekë dhe realizim faktik 3.7 milion lekë për implementimin e 4 projekteve.

4.1.8 Programi Buxhetor "Mbështetje për Energjinë"

Realizimi financiar i programit buxhetor "Mbështetje për Energjinë" sipas burimit të financimit dhe në nivel klasifikimi buxhetor rezulton të jetë:

Plani fillestar 2025	Plani rishikuar 2025	Realizimi në lekë	Realizimi në%
-------------------------	-------------------------	----------------------	------------------

Shpenzime korrente	120,520,000	46,134,000	45,236,015	98%
Shpenzime kapitale FB	250,000,000	448,700,000	437,191,226	97%
Shpenzime kapitale FH	3,000,000,000	1,563,000,000	1,463,094,332	94%

Në shpenzimet korrente të programit, plani i rishikuar 2025 është ulur me vlerën 74,386,000 lekë që vjen nga:

- Akordimi i fondit të veçantë në vlerën 610,000 lekë dhe me realizim financiar në vlerën 233,200 lekë, për 2 raste dhënie ndihmë fatkeqësie dhe për një rast dalje në pension.
- Nga zbatimi i Aktit Normativ nr.11, datë 19.12.2025 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin e buxhetit të vitit 2025", plani u pakësua me vlerën 74,996,000 lekë.

Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm, plani i rishikuar 2025 është ulur me vlerën 198,700,000 lekë si vijon:

- Nga zbatimi i Aktit Normativ nr.10, datë 08.10.2025 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin e buxhetit të vitit 2025", plani është rritur me vlerën 203,700,000 lekë.
- Nga zbatimi i Aktit Normativ nr.11, datë 19.12.2025 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin e buxhetit të vitit 2025", plani është ulur me vlerën 5,000,000 lekë.

Shpenzimet kapitale me financim të huaj, plani i rishikuar 2025 ka një ulje të me vlerën 1,437,000,000 lekë si vijon:

- Nga zbatimi i Aktit Normativ nr.10, datë 08.10.2025 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin e buxhetit të vitit 2025", plani u pakësua me vlerën 1,000,000,000 lekë.
- Nga zbatimi i Aktit Normativ nr.11, datë 19.12.2025 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin e buxhetit të vitit 2025", plani u pakësua me vlerën 437,000,000 lekë.

Si më poshtë vijon, paraqiten të dhënat krahasuese për realizimin financiar për të njëjtën periudhë të vitit 2024. Rezulton se për vitin 2025, ka një realizim më të ulët në vlerë nominale dhe më të lartë në %.

në / 000 lekë

Shpenzimet Korrente	Realizimi Financiar Viti 2024	Realizimi Financiar Viti 2025
Artikulli 600	32,268	33,174
Artikulli 601	5,153	5,357
Artikulli 602	65,417	6,481
Artikulli 605	0	0
Artikulli 606	41	223
TOTALI	102,879	45,236
REALIZIMI NË%	91%	98%

Shpenzimet korrente në program shërbejnë për mirëfunksionimin e aktivitetit operacional të 2 njësive shpenzuese të varësisë:

- ✓ Agjencia Kombëtare Bërthamore me numër faktik 7 punonjës;
- ✓ Agjencia e Eficiencës së Energjisë me numër faktik 19 punonjës;

Realizimi i shpenzimeve kapitale me financim të brendshëm të programit, krahasuar me periudhën referuese të vitit 2024, ka një realizim më të lartë si në vlerë nominale ashtu dhe në %

Shpenzimet Kapitale FB	Realizimi Financiar Viti 2024	Realizimi Financiar Viti 2025
Artikulli 230	65,966	133,140
Artikulli 231	355,005	304,050
TOTALI	420,971	437,191
REALIZIMI NË%	88%	97%

Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm të programit realizohen nga 3 njësi shpenzuese të varësisë si vijon:

- ✓ Aparati i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, me plan të shpenzimeve kapitale prej 35 milion lekë dhe realizim financiar 31.3 milion lekë, për implementimin e 1 projekti;
- ✓ Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, me plan dhe realizim të shpenzimeve kapitale prej 34 milion lekë për implementimin e 8 projekteve;
- ✓ Agjencia e Eficiencës së Energjisë, me plan të shpenzimeve kapitale prej 379,7 milion lekë dhe realizim financiar në vlerën 371.8 milion lekë, për implementimin e 17 projekteve të eficiencës së energjisë;

Realizimi i shpenzimeve kapitale me financim të huaj të programit krahasuar me të njëjtën periudhë referuese të vitit 2024, ka një realizim më të ulët në vlerë nominale, dhe më i lartë në %.

Shpenzimet Kapitale FH	Realizimi Financiar Viti 2024	Realizimi Financiar Viti 2025
Artikulli 230	34,996	0
Artikulli 231	1,497,016	1,463,094
TOTALI	1,532,012	1,463,094
REALIZIMI NË%	55%	94%

Shpenzimet kapitale me financim të huaj të programit realizohen nga disa njësi shpenzuese si vijon:

- ✓ Aparati i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, për implementimin e projektit:
 - Konvikte të rinovuara me efikasitet të energjisë Qyteti Studentit nr 1, program i Rehabilitimit të Konvikteve të Universitetit të Tiranës;
 - Programi i Rehabilitimit të Konvikteve të Universitetit të Tiranës sipas Parimit të Eficiencës së Energjisë (FAZAT 1 deri 4);
- ✓ Shoqëria KESH sha (PIU), për implementimin e projektit:
 - Rehabilitimi i Hidrocentralit të Fierzës (DKT);
- ✓ Shoqëria OSHEE Grop sha, për implementimin e 2 projekteve;
 - SCADA (Zgjerimi i sistemit SCADA në godinën Qendrore të OSHEE);
 - Programi i Investimeve për Shpërndarjen e Energjisë Elektrike I (Kredi dhe Grant);
- ✓ Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore për implementimin e projekteve IPA;
- ✓ Sekretariati i Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (EITI)
 - Mbështetje për vazhdimësinë për nismën për transparencë në industrinë nxjerrëse EITI;

4.1.9 Programi Buxhetor "Transporti Rrugor"

Realizimi financiar i programit buxhetor "Transporti Rrugor" sipas burimit të financimit dhe në nivel klasifikimi buxhetor rezulton të jetë:

	Plani fillestar 2025	Plani rishikuar 2025	Realizimi në lekë	Realizimi në%
Shpenzime korrente	3,660,122,000	4,722,736,470	4,602,108,520	97%
Shpenzime kapitale FB	26,236,699,000	34,560,900,000	34,355,774,690	99%
Shpenzime kapitale FH	3,588,323,000	5,037,021,000	2,765,952,402	55%

Në shpenzimet korrente të programit, plani i rishikuar 2025 ka një rritje prej 1,062,614,470 lekë që vjen nga:

- ✓ Rialokimi i fondit të veçantë, në vlerën 1,453,470 lekë dhe realizim financiar në vlerën 830,977 lekë, për pesë raste dhënie ndihme për fatkëqësi, një rast dhënie ndihmë për arsye shëndetsore dhe për gjashtë raste dalje në pension.
- ✓ Nga zbatimi i Aktit Normativ nr.10, datë 08.10.2025 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.115/2024 "Për buxhetin e vitit 2025", plani u shtuan me vlerën 88,850,000 lekë;
- ✓ Nga zbatimi i Aktit Normativ nr.11, datë 19.12.2025 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.115/2024 "Për buxhetin e vitit 2025", plani u shtua me vlerën 972,311,000 lekë;

Në shpenzimet kapitale me financim të brendshëm, në buxhetin e rishikuar për vitin 2025, efekti buxhetor shtesë, në vlerën 8,324,201,000 lekë ka ardhur si rezultat:

- ✓ Nga zbatimi i Aktit Normativ nr.10, datë 08.10.2025 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.115/2024 "Për buxhetin e vitit 2025", plani u shtua me vlerën 2,427,900,000 lekë;
- ✓ Nga zbatimi i Aktit Normativ nr.11, datë 19.12.2025 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.115/2024 "Për buxhetin e vitit 2025", plani u shtua me vlerën 5,846,301,000 lekë;
- ✓ Nga zbatimi i VKM nr.821 datë 30.12.2025 për rritje shtesë të kapitalit për shoqërinë EKORR sh.a", u akorduar fond shtesë në vlerën 50,000,000 lekë;

Në shpenzimet kapitale me financim të huaj plani i rishikuar për vitin 2025, u shtua me vlerën 1,448,698,000 lekë, si rezultat:

- ✓ Nga zbatimi i Aktit Normativ nr.10, datë 08.10.2025 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.115/2024 "Për buxhetin e vitit 2025", plani u shtua me vlerën 1,693,598,000 lekë;
- ✓ Nga zbatimi i Aktit Normativ nr.11, datë 19.12.2025 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.115/2024 "Për buxhetin e vitit 2025", plani u pakësua me vlerën 244,900,000 lekë;

Si më poshtë vijon, paraqiten të dhënat krahasuese për realizimin financiar për të njëjtën periudhë të vitit 2024. Rezulton se për vitin 2025 ka një realizim më të lartë në vlerë nominale, por më të ulët në %.

në / 000 lekë

Shpenzimet Korrente	Realizimi Financiar Viti 2024	Realizimi Financiar Viti 2025
Artikulli 600	267,223	314,129
Artikulli 601	44,684	52,308
Artikulli 602	3,721,125	4,324,840
Artikulli 605	0	0
Artikulli 606	2,067	831
TOTALI	4,035,099	4,602,108
REALIZIMI NË%	99%	97%

Shpenzimet korrente në program shërbëjnë për mirëfunksionimin e aktivitetit operacional të njësive shpenzuese si vijon:

- ✓ Autoriteti Rrugor Shqiptar, me një numër faktik 138 punonjës;
- ✓ Drejtoria e Rajonit Qendror Tiranë, me një numër faktik 41 punonjës;
- ✓ Drejtoria e Rajonit Verior Shkodër, me një numër faktik 46 punonjës;
- ✓ Drejtoria e Rajonit Jugor Gjirokastrë, me një numër faktik 41 punonjës;
- ✓ Drejtoria e Rajonit Qendër Lindje Korçë me një numër faktik 44 punonjës;
- ✓ Instituti i Transportit, me numër faktik 14 punonjës;

Artikulli 602 përmban jo vetëm shpenzimet e administrimit për njësitë shpenzuese të sipërcituara, por edhe shpenzimet e kontratave të mirëmbajtjes së rrugëve.

ARRSH administron një rrjet rrugor prej 3522 km nga të cilat:

- ✓ 1400 km janë rrugë primare dhe mirëmbahen me 4 kontrata mirëmbajtje;
- ✓ 2122 km janë rrugë sekondare që mirëmbahen me 48 kontrata mirëmbajtje;

Buxheti i rishikuar për vitin 2025 për kontratat e mirëmbajtjes :

- Plan i rishikuar është në vlerën 4,023,502,061 lekë;
- Realizimi financiar është në vlerën 3,912,791,639 lekë ose 97% e planit.

Realizimi i shpenzimeve kapitale me financim të brendshëm të programit për vitin 2025, krahasuar me periudhën referuese të vitit 2024, ka një realizim më të ulët si në vlerë nominale, ashtu dhe në %

në / 000 lekë

Shpenzimet Kapitale FB	Realizimi Financiar Viti 2024	Realizimi Financiar Viti 2025
Artikulli 230	150,413	211,477
Artikulli 231	34,544,021	34,084,297
Artikulli 232	0	60,000
TOTALI	34,694,435	34,355,774
REALIZIMI NË%	100 %	99%

Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm të programit realizohen nga njësitë shpenzuese të varësisë si vijon:

- ✓ Aparati i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, me plan të shpenzimeve kapitale dhe realizim financiar në vlerën 5,4 miliard lekë, për implementimin e projekteve koncensionare të infrastrukturës rrugore;
- ✓ Autoriteti Rrugor Shqiptar, me plan të shpenzimeve kapitale prej 29.1 miliard lekë dhe realizim financiar 28.9 miliard lekë, për implementimin e projekteve infrastrukturore;
- ✓ Instituti Studimeve të Transportit Tiranë, me plan të shpenzimeve kapitale prej 3 milion lekë dhe realizim financiar 2.4 milion lekë;

Realizimi i shpenzimeve kapitale me financim të huaj të programit për vitin 2025, krahasuar me periudhën referuese të vitit 2024, ka një realizim më të ulët si në vlerë nominale ashtu dhe në %,.

Shpenzimet Kapitale FH	Realizimi Financiar Viti 2024	Realizimi Financiar Viti 2025
Artikulli 230	308,330	38,012
Artikulli 231	3,018,457	2,727,939
TOTALI	3,326,787	2,765,952
REALIZIMI NË%	98%	55%

Shpenzimet kapitale me financim të huaj të programit realizohen nga Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe Njësitë e menaxhimit të projekteve të huaja dhe Instituti i Transportit:

- ✓ Përmirësimi dhe rehabilitimi i Urave (Financim i Bankës Botërore);
- ✓ Ndërtim segmenti rrugor Qukës – Qafë Pllocë Loti 1, Loti 2, Loti 3;
- ✓ Studim projekte për Urën e Vjosës, Beshirit, urën e grupit A dhe urën e grupit B;
- ✓ Projekte IPA;

4.1.10 Programi Buxhetor "Transporti Hekurudhor"

Realizimi financiar i programit buxhetor "Transporti Hekurudhor" sipas burimit të financimit dhe në nivel klasifikimi buxhetor rezulton të jetë:

	Plani fillestar 2025	Plani rishikuar 2025	Realizimi në lekë	Realizimi në%
Shpenzime korrente	537,500,000	515,753,200	515,609,702	100 %
Shpenzime kapitale FB	550,000,000	525,000,000	510,215,049	97%
Shpenzime kapitale FH	4,992,702,000	2,619,704,000	2,384,637,619	91%

Në shpenzimet korrente të programit, plani i rishikuar 2025, është pakësuar me vlerën 21,746,800 lekë që vjen nga:

- Rialokimi i fondit të veçantë në vlerën 113,200 lekë, i realizuar për një rast dalje në pension.
- Nga zbatimi i Aktit Normativ nr.11, datë 19.12.2025 "Për disa ndryshime në ligjin e buxhetit të vitit 2025", plani u pakësua me vlerën 21,860,000 lekë.

Në shpenzimet kapitale me financim të brendshëm të programit, plani i rishikuar për vitin 2025, është pakësuar me vlerën 25,000,000 lekë që vjen nga:

- Nga zbatimi i Aktit Normativ nr.10, datë 08.10.2025 "Për disa ndryshime në ligjin e buxhetit të vitit 2025", plani u shtua me fondin 364,400,000 lekë;
- Nga zbatimi i Aktit Normativ nr.11, date 19.12.2025 "Për disa ndryshime në ligjin e buxhetit të vitit 2025", plani u pakësua me fondin 389,400,000 lekë;

Në shpenzimet kapitale me financim të huaj të programit, plani i rishikuar për vitin 2025, është rritur me vlerën 2,372,998,000 lekë që vjen nga:

- Nga zbatimi i Aktit Normativ nr.10, datë 08.10.2025 "Për disa ndryshime në ligjin e buxhetit të vitit 2025", plani është pakësuar me vlerën 710,398,000 lekë;

- Nga zbatimi i Aktit Normativ nr.11, date 19.12.2025 "Për disa ndryshime në ligjin e buxhetit të vitit 2025", plani është pakësuar me vlerën 1,662,600,000 lekë;

Në shpenzimet korrente të programit, paraqiten të dhënat krahasuese për realizimin financiar për të njëjtën periudhë të vitit 2024. Rezulton se për vitin 2025 realizimi financiar është më i lartë në vlerë nominale ashtu edhe në %.

në / 000 lekë

Shpenzimet Korrente	Realizimi Financiar Viti 2024	Realizimi Financiar Viti 2025
Artikulli 600	6,751	13,277
Artikulli 601	1,190	2,053
Artikulli 602	586	182
Artikulli 603	500,000	500,000
Artikulli 606	15	96
TOTALI	508,542	515,609
REALIZIMI NË%	99%	100%

Shpenzimet korrente në program shërbëjnë për mirëfunksionimin e aktivitetit operacional të njësive shpenzuese si vijon:

- ✓ Autoriteti Sigurisë Hekurudhore me numër faktik prej 6 punonjësh.
- ✓ Autoriteti Rregullator Hekurudhor; me numër faktik prej 1 punonjësh.
- ✓ Hekurudha Shqiptare Sh.A e cila administron fondin buxhetor të artikullit 603 "Subvencione";

Realizimi i shpenzimeve kapitale me financim të brendshëm të programit për vitin 2025, krahasuar me periudhën karahasuese të vitit 2024, rezulton më i ulët në vlerë nominale dhe më i lartë në %.

në / 000 lekë

Shpenzimet Kapitale FB	Realizimi Financiar Viti 2024	Realizimi Financiar Viti 2025
Artikulli 230	55,280	85,918
Artikulli 231	638,502	424,297
TOTALI	693,782	510,215
REALIZIMI NË%	75 %	97%

Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm të programit realizohen nga shoqëria Hekurudha Shqiptare sha për implementimin:

- ✓ 2 projekte për studim projekte të buxhetuara në vlerën 98 milion lekë dhe realizim faktik në vlerën 85.9 milion lekë.
- ✓ 2 projekte për mirëmbajtje të ndryshme dhe rinovime të trungut hekurudhor të buxhetuara në vlerën 26.6 milion lekë dhe realizim faktik në vlerën 25.7 milion lekë;
- ✓ TVSH për projektet me financim të huaj të programit të buxhetuara në vlerën 400.3 milion lekë dhe realizim faktik në vlerën 398.5 milion lekë;

Realizimi i shpenzimeve kapitale me financim të huaj të programit për vitin 2025, krahasuar me periudhën referuese të vitit 2024, ka një realizim më të lartë si në vlerë nominale ashtu dhe në %.

Shpenzimet Kapitale FH	Realizimi Financiar Viti 2024	Realizimi Financiar Viti 2025
Artikulli 230	9	4,958
Artikulli 231	1,368,637	2,379,679
TOTALI	1,368,646	2384,637
REALIZIMI NË%	32%	91%

Shpenzimet kapitale me financim të huaj të programit realizohen nga shoqëria "Hekurudha Shqiptare", sha.

- ✓ Rehabilitimi i linjës hekurudhore Durrës-Termali i pasagjerëve Tiranë dhe ndërtimi i linjës hekurudhore Tiranës-Rinas;
- ✓ Zbatimi i projektit inxhinierik dhe arkitektonik i godinave të stacioneve hekurudhore Durrës-Tiranë TTP-Rinas Aeroport;
- ✓ Hartimi i projektit të detajuar Rrogozhinë – Pogradec;

4.1.11 Programi Buxhetor "Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime"

Realizimi financiar i programit buxhetor "Furnizimi me ujë dhe Kanalizime" sipas burimit të financimit dhe në nivel klasifikimi buxhetor rezultojnë të jetë:

	Plani fillestar 2025	Plani rishikuar 2025	Realizimi në lekë	Realizimi në%
Shpenzime korrente	620,470,000	566,703,200	553,211,215	98%
Shpenzime kapitale FB	11,332,606,000	11,825,665,000	11,658,363,761	99%
Shpenzime kapitale FH	2,207,004,000	2,638,004,000	3,104,150,984	118%

Në shpenzimet korrente të programit, plani i rishikuar 2025 është ulur me vlerën 53,766,800 lekë, si vijon:

- Alokimi i fondit të veçantë në vlerën 233,200 lekë, i financuar për një rast dalje në pension dhe katër raste dhënie ndihme për rast fatkeqësie.
- Nga zbatimi i Aktit Normativ nr.11, date 19.12.2025 "Për disa ndryshime në ligjin e buxhetit të vitit 2025", plani është pakësuar me fondin 54,000,000 lekë;

Si më poshtë vijon, paraqiten të dhënat krahasuese për realizimin financiar për të njëjtën periudhë të vitit 2024. Rezultojnë se për vitin 2025 ka një realizim më të lartë si në vlerë nominale ashtu dhe në %.

Shpenzimet Korrente	Realizimi Financiar Viti 2024	Realizimi Financiar Viti 2025
Artikulli 600	109,262	151,240
Artikulli 601	17,749	24,753
Artikulli 602	32,996	26,985
Artikulli 603	350,000	350,000
Artikulli 606	150	233
TOTALI	510,178	553,211
REALIZIMI NË%	95%	98%

Shpenzimet korrente në program shërbejnë për mirëfunksionimin e aktivitetit operacional të Agjensisë Kombëtare të Ujësjellës Kanalizimeve dhe strukturës Task Forcë të ngritur brenda kësaj njësie shpenzuese.

AKUK administron dhe shpenzimet e artikullit 603 "Subvencion". Këto shpenzime përdoren në zbatim të udhëzimit respektiv të Ministrit të Infrastruktës dhe Energjisë në kuadër të rritjes së performancës financiare të shoqërive ujësjellës kanalizimeve të krijuara në kuadër të reformës së ujit.

Në shpenzimet kapitale me financim të brendshëm të programit, plani i rishikuar 2025 ka një rritje të tavanit buxhetor me vlerën 493,059,000 lekë, si vijon:

- Në kuadër të Aktit Normativ nr.6, datë 11.06.2025 "Për disa ndryshime në ligjin e buxhetit të vitit 2025", u miratua transferimi i fondeve buxhetore në vlerën totale prej 227,155,785 lekë;
- Në zbatim të Aktit Normativ nr.11, datë 19.12.2025 "Për disa ndryshime në ligjin e buxhetit të vitit 2025", plani u rrit me vlerën 493,059,000 lekë.

Realizimi i shpenzimeve kapitale me financim të brendshëm të programit për vitin 2025 krahasuar me periudhën referuese të vitit 2024, rezulton me një realizim më të lartë në vlerë nominale dhe të njëjtë në %.

Shpenzimet Kapitale FB	në / 000 lekë	
	Realizimi Financiar Viti 2024	Realizimi Financiar Viti 2025
Artikulli 230	137,454	316,104
Artikulli 231	11,055,022	11,342,259
TOTALI	11,192,476	11,658,363
REALIZIMI NË%	99 %	99%

Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm të programit realizohen nga Agjensia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizimeve dhe shoqëritë e ujësjellës kanalizimeve të krijuara nga Reforma e Ujit me nënërat, ku gjatë vitit 2025 janë implementuar:

- ✓ 115 produkte investimesh të infrastrukturës të ujësjellës kanalizimeve, planifikuar në vlerën 11.1 miliard lekë dhe janë realizuar 11 miliard lekë ose 99% e sasisë së realizuar.
- ✓ 8 projekte në sasi produkti, në vlerën 123.7 milion leke, nuk janë realizuar për mos dorëzimin në afat të dokumentacionit teknik – financiar ose 1% e sasisë së planifikuar;
- ✓ 4 projekte të planifikuara dhe të realizuara në sasi, për mbështetjen buxhetore (tvsh dhe kosto lokale), në vlerën 639.4 milion lekë dhe janë realizuar në vlerën 638.7 milion leke ose 100%.
- ✓ Ndërtim rrjeti ujësjellësi dhe rikonstruksion rrjeti:
 - *Sasia (sipas planit Fillestar Vjetor) 480,642.97 ml*
 - *Sasia (sipas /planit të rishikuar të vitit korent) 515,955.85 ml*
 - *Sasia (sipas /periudhës raportuese të vitit korent) 488,206.6 ml*
- ✓ Ndërtim rrjet kanalizimi dhe ITUN dhe rikonstruksion rrjeti:
 - *Sasia (sipas planit Fillestar Vjetor) 82,220ml*
 - *Sasia (sipas /planit të rishikuar të vitit korent) 32,254ml*
 - *Sasia (sipas /periudhës raportuese të vitit korent) 29,718ml*

Në shpenzimet kapitale me financim të huaj të programit, plani i rishikuar 2025 ka një rritje të tavanit buxhetor me vlerën 431,000,000 lekë, si vijon:

- Në zbatim të Aktit Normativ nr.11, datë 19.12.2025 "Për disa ndryshime në ligjin e buxhetit të vitit 2025", plani u shtua me vlerën 431,000,000 lekë.

Realizimi i shpenzimeve kapitale me financim të huaj të programit për vitin 2025, krahasuar me periudhën referuese të vitit 2024, ka një realizim më të lartë si në vlerë nominale, ashtu dhe në %.

në / 000 lekë

Shpenzimet Kapitale FH	Realizimi Financiar Viti 2024	Realizimi Financiar Viti 2025
Artikulli 230	896,965	0
Artikulli 231	515,526	3,104,150
TOTALI	1,412,491	3,104,150
REALIZIMI NË%	85%	118%

Shpenzimet kapitale me financim të huaj të programit realizohen nga Agjencia Kombëtare e Ujësjetës Kanalizimeve dhe njësitë e menaxhimit të projekteve në AKUK, si vijon:

- ✓ Planifikimi sektorit të ujit për negociata me BE;
- ✓ Infrastruktura Bashkiake III, IV, V;
- ✓ Mjedis i pastër dhe me aftësi ripërtëritëse për projektin Deti Blu;
- ✓ Furnizimi qëndrueshëm me ujë nëpërmjet energjisë së gjelbër;
- ✓ Programi kombëtar i modernizimit të sektorit të Ujësjetës Kanalizimeve;
- ✓ Projekt i rikonstruksionit të rrjetit të brendshëm të ujësjetës për Bashkinë Durrës;
- ✓ Projekti i kanalizimeve të Tiranës së Madhe;

4.2 PERFORMANCA JO FINANCIARE E PROGRAMIT BUXHETOR

4.2.1 Programi Buxhetor "Planifikim menaxhim Administrim"

Programi "Planifikim, Menaxhim, Administrim" ka si objektiv funksionimin dhe forcimin e kapaciteteve administrative, përmirësimin e strukturës funksionale për një menaxhim sa më efektiv të burimeve njerëzore, krijimin e një stafi permanent dhe sa më të qëndrueshëm, aplikimin e proceseve transparente të konkurimit në përputhje me parimet e barazisë gjinore, motivimin për ngritjen në detyrë sipas rezultateve, me qëllim rritjen e standardeve dhe performancës së punës.

Qëllimi i programit është mirëmenaxhimi i stafit të aparatit të MIE-së dhe politikbërja me sukses brenda fushës së përgjegjësisë shtetërore të institucionit duke respektuar parimin e barazisë gjinore dhe mosdiskriminimin.

Treguesit e performancës në këtë program janë:

- ✓ Forcimi kapaciteteve administrative nëpërmjet trajnimeve të ndryshme për punonjësit e Administratës 55%
- ✓ Gra të përfaqësuara në nivele të larta drejtuese të Aparatit të MIE 4
- ✓ Raporti gra ndaj totalit të punonjësve të Aparatit të MIE 145
- ✓ Raporti burra ndaj totalit të punonjësve të Aparatit të MIE 60

4.2.2 Programi Buxhetor "Planifikimi Urban"

Ky program harton, mbështet dhe zbaton procese dhe politika për planifikimin. Ka për qëllim ndër të tjera të sigurojë zhvillimin e qëndrueshëm të territorit; të vlerësojë potencialin aktual e perspektiv për zhvillimin e territorit në nivel kombëtar, rajonal e vendor; të mundësojë të drejtën e përdorimit e të zhvillimit të pronës; të

krijojë kushte të përshtatshme e të drejta dhe shanse të barabarta, të sigurojë që autoritetet kombëtare e vendore të planifikimit të hartojnë e të përditësojnë rregullisht dokumentet e planifikimit.

Pjesë e aktiviteteve të këtij programi janë dy institucione varësie:

1. Arkivi Qëndror Teknik i Ndërtimit (AQTN), që mbledh, përpunon, administron, ruan dhe shërben pasurinë arkivore, e cila mbrohet dhe sigurohet nga shteti. Kjo pasuri është dokumentacion teknik me vlera shkencore, teorike e praktike, në fushën e ndërtimit, me interes historik kombëtar dhe është pjesë e Fondit Arkivor Kombëtar Shqiptar (F A K SH).
2. Agjencia Shtetërore për Shpronësimin (ASHSH), funksioni i së cilës është të garantojë që procedurat e shpronësimit ose të marrjes në përdorim të përkohshëm, për interes publik, të pasurive të personave fizikë ose juridikë privatë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë të realizohen në përputhje me kushtet dhe procedurat e përcaktuara me legjislacionin në fuqi, duke garantuar transparencën, barazinë e shtetasve dhe mbrojtjen e interesave dhe të drejtave të tyre pasurore.

Politikat e këtij programi synojnë:

- Planifikim dhe zhvillim të qëndrueshëm të territorit në çdo nivel dhe në bashkërendim me çdo sektor;
- Rigjenerimin urban dhe krijimin e modeleve të reja të zhvillimit të territorit;
- Mundëson kushte të përshtatshme për stafin i cili merret me çështjet e planifikimit dhe zhvillimit të territorit;
- Përmirëson kuadrin ligjor në fushën e projektimit;

Qëllimi i politikës së këtij programi është:

- Zhvillimi i qëndrueshëm dhe i balancuar i territorit, garantimin e ekuilibrit midis interesave publikë dhe privatë, në zhvillimin e territorit;
- Kryerja e procesit mbi rikualifikimin urban të zonave përmes projektsh pilot, urbanizimi dhe integrimi;
- Hartimin e rregullave dhe standarteve të projektimit në fushat e projektimit të universiteteve dhe ambjentet ndihmëse të tyre;
- Dixhitalizimin e dokumentave që lidhen me planifikimin dhe zhvillimin e territorit;
- Ruajtjen e të drejtës së pronësisë për çdo individ;

4.2.3 Programi Buxhetor "Mbështetje për Rrjetet e Komunikacionit"

Programi Buxhetor "Mbështetje për Rrjetet e Komunikacionit", është një nga programet prioritare të fushës së përgjegjësisë së MIE. Objektivat e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë përfshijnë dhe politikat e përgjithshme shtetërore në sektorin e telekomunikacionit dhe të shërbimit postar, për hartimin dhe zbatimin e politikës së përgjithshme shtetërore, në sektorin e planifikimit dhe zhvillimit urban, në sektorin e infrastrukturës dhe transportit, në sektorin e telekomunikacionit dhe të shërbimit postar, në sektorin e energjisë, shfrytëzimit të burimeve energjetike e minerare dhe në sektorin e industrisë;

Për mbështetjen e zbatimit të politikave të zhvillimit të telekomunikacionit është miratuar programi "Mbështetje për Rrjetet e Komunikacionit", si pjesë integrale e programit buxhetor të MIE. Gjatë periudhës së raportimit Janar-Prill 2024, vëmendja kryesore e MIE në lidhje me programin mbështetje për rrjetet e komunikimit, ka qenë miratimi i ligjit të ri për komunikimet elektronike, identifikimi i masave/reformave prioritare që janë pjesë e planit të ri të rritjes në lidhje me infrastrukturën digjitale dhe rrjetet 5G. Në fokusin e punës së MIE gjatë periudhës së raportimit ka qenë zbatimi i planit kombëtar të broadband, ndjekja e angazhimeve të integritit evropian dhe promovimi i pjesëmarrjes në Programin Digjital të BE-së.

Investime në fibër optike në zonat e bardha, bazuar në gjetjet dhe rekomandimet e projektit "Studim Fizibiliteti për zhvillimin e infrastrukturës rajonale të Broadband-it" (WB19-ALB-DII-01), si dhe në

përmbushje të objektivave të vendosura në Planin Kombëtar për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Infrastrukturës Digjitale, Broadband 2020-2025, miratuar me VKM nr. 434 datë 3.6.2020, nevoja për investime në fibër optike në zonat e bardha është e lartë. Investimi pritet të bëhet pas përfundimit të asistencës teknike WEB24-ALB-DII-01 që do të përditësojë studimin e fizibilitetit, CBA dhe përgatisë tender document.

Zbatimi i Marrëveshjes Shqipëri-Kosovë mbi Autostradën Digjitale 5G Prishtinë-Tiranë, është i lidhur me zhvillimet e rrjeteve të së ardhmes dhe zbatimit të aplikacioneve digjitale, inovacionin për industrinë vertikale (energji, transport), qytetet e zgjuara (smart cities) dhe zhvillimet inovatore në ekonomi dhe shoqëri. Infrastruktura digjitale e shpejtësisë së lartë dhe shumë të lartë nënkupton rrjete me fibër optike dhe 5G. Aktualisht rrjetet 5G nuk janë prezent në Shqipëri. Nevoja për investime për zhvillimin e tyre është e lartë. Në fazën e parë del nevoja e kryerjes së një studimi për implementimi e Marrëveshjes Shqipëri-Kosovë mbi Autostradën Digjitale 5G Prishtinë-Tiranë;

Zbatimi i kuadrit të ri ligjor për komunikimet elektronike përmes draftimit të akteve nënligjore në zbatim të tij lidhet me miratimin e ligjit të ri të komunikimeve elektronike. Projektligji i ri “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i bazuar në Direktivën BE 2018/1972, është miratuar nga Këshilli i Ministrave me VKM nr.99 datë 06.03.2024, dhe ka kaluar për miratim në Kuvend. Aktualisht projektligji është në proces shqyrtimi në komisionet parlamentare dhe pritet të miratohet në seancë plenare brenda muajit maj 2024. Për implementimin e këtij ligji lind nevoja e draftimit të akteve nën ligjore që rrjedhin prej tij, të parashikuara në programin buxhetor të vitit 2024. Gjithashtu për implementimin e ligjit të ri lind nevoja e planit të komunikimi si dhe promovimit të zbatimit të ligjit të ri për komunikimet elektronike.

WiFi4AL - Sigurimi i mbulimit me Ëi-Fi falas për qytetarët dhe vizitorët në hapësirat publike si parqe, sheshe, ndërtesa publike, biblioteka, qendra shëndetësore dhe muze në Shqipëri përmes projektit WiFi4AL – në zbatim të Planit Kombëtar të Broadbandit. Objektivi i këtij projekti është ofrimi i Wi-Fi falas për qytetarët dhe vizitorët në hapësirat publike si parqe, sheshe, ndërtesa publike, biblioteka, qendra shëndetësore dhe muze në Shqipëri.

Programin Digjital i BE-së është miratuar nga Bashkimi Evropian me Rregulloren (EU) 2021/694, për të mbështetur transformimin digjital në periudhën 2021-2027 i cili përmban pesë objektiva specifike:

- Objektivi 1: Përpunimi kompjuterik me performancë të lartë;
- Objektivi 2: Inteligjenca artificiale, të dhënat dhe cloud;
- Objektivi 3: Siguria kibernetike dhe besimi;
- Objektivi 4: Aftësitë digjitale të avancuara;
- Objektivi 5: Përsheptimi i përdorimit sa më të mirë të teknologjive digjitale.

Transformimi digjital ka një prekje të gjerë si nga sektori publik, ekonomia, academia, industria, etj. Ky proces ka nevojë për rritjen e kapaciteteve teknike, zhvillimin e projekteve, infrastrukturës digjitale, zgjidhje/platforma inovatore digjitale, aftësive digjitale, etj.

4.2.4 Programi Buxhetor "Transporti Ajror"

Programi buxhetor "Transporti Ajror", merret me hartimin e politikave zhvilluese të transportit ajror që synojnë përmirësimin e kuadrit ligjor dhe administrativ, në përputhje të plotë me standardet ndërkombëtare dhe për të mundësuar gjetjen e burime të ndryshme financuese dhe investuese për infrastrukturën aeroportuale, me qëllim krijimin e një tregu konkurrues në shërbimet ajrore.

Autoriteti Kombëtar i Investigimit për Sigurinë e Operimit në Aviacionin Civil është themeluar në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 100, pika 2, e 101, të ligjit 96/2020, “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë. Autoriteti i Investigimit ka si mision përmirësimin e sigurisë ajrore dhe parandalimin e

aksidenteve dhe incidenteve, nëpërmjet investigimit të tyre dhe nxjerrjes së shkaqeve, në zbatim të legjislacionit në fuqi. Investigimi i aksidenteve dhe i incidenteve të rënda kryhet nga AKISA (safety) në Aviacionin Civil, në varësi të Ministrisë përgjegjëse për transportin.

Qëllimet e Politikës së Programit: Integrimi i aviacionit civil shqiptar në sistemet evropiane të transportit ajror në nivel administrativ dhe nivel tekniko-funksional.

Objektivat dhe produktet të cilat synohen të arrihen gjatë kësaj periudhe, përgjithësisht janë të lidhur me:

- zhvillimin dhe ndërtimin e infrastrukturave të reja aeroportuale, me qëllim krijimin e një tregu konkurrues me shërbime ajrore të liberalizuara;
- rritjen e standardeve dhe performancës së Autoritetit Kombëtar të Investigimit për Sigurinë e Operimit në Aviacionin Civil nëpërmjet investimeve për forcimin e kapaciteteve;

4.2.5 Programi Buxhetor "Mbështetje për Industrinë"

Programi "Mbështetje për Industrinë" ka për qëllim rritjen e nivelit të sigurisë së shfrytëzimit, mirëmbajtjes dhe përdorimit të produkteve, pajisjeve, instalimeve industriale, instalimeve elektrike dhe pajisjeve nën presion, eliminimin e rrezikut të dëmtimit të shëndetit të njerëzve dhe mjedisit nga kimikatet e rrezikshme të papërdorshme gjendje në kushte të pa sigurta depozitimi dhe ruajtje në magazinat apo ambientet e ish ndërmarrjeve dhe ndërmarrjeve publike në varësi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

Pjesë e aktiviteteve të këtij programi janë:

1. Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial, i cili ushtron një veprimtari të gjerë, të shtrirë në të gjithë territorin e vendit për inspektimin, zbatimin dhe përmbushjen e kërkesave ligjore e nënligjore në fushën e përpunimit, transportimit dhe tregtimit të naftës, gazit e nënprodukteve të tyre, si dhe të sigurimit të punës për instalimet, pajisjet nën presion, për pajisjet dhe instalimet elektrike dhe të sistemeve të gazifikimit dhe impianteve kombëtare.
2. Qendra e Grumbullimit dhe Trajtimit të Kimikateve të Rrezikshme ka për mision reduktimin e rrezikut të ndotjes të mjedisit dhe dëmtimit të shëndetit të njerëzve nga keqpërdorimi apo trafikimi për përfitime të paligjshme të kimikateve të rrezikshme, të mbetura në kushte të pasigurta depozitimi dhe ruajtjeje në magazinat apo ambientet e ish-ndërmarrjeve dhe subjekteve publike të fushës së veprimtarisë së Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

Politikat e këtij programi synojnë:

- Nxitjen e interesit për investime të biznesit vendas dhe të huaj në zhvillimin e veprimtarisë industriale;
- Rritjen e nivelit të sigurisë së shfrytëzimit, mirëmbajtjes dhe përdorimit të produkteve, pajisjeve, instalimeve industriale, instalimeve elektrike dhe pajisjeve nën presion.
- Eliminimin e rrezikut të dëmtimit të shëndetit të njerëzve dhe mjedisit nga kimikatet e rrezikshme të papërdorshme gjendje në kushte të pa sigurta depozitimi dhe ruajtjeje në magazinat apo ambientet e ish ndërmarrjeve dhe ndërmarrjeve publike.

Qëllimi i politikës së këtij programi është:

- Sigurimi i kushteve për monitorimin e standarteve teknike në fushën e hidrokarbureve, minierave dhe industrisë, për problemet e sigurisë së produkteve/pajisjeve/instalimeve dhe në tërësi veprimtarisë industriale në fushën e nxjerrjes dhe përpunimit si dhe në punimet nëntokësore të veprave hidroenergjetike.
- Krijimi i kushteve për miradministrimin e kimikateve të trashëguara dhe dy landfilleve në të cilat janë depozituar mbetjet e rrezikshme si dhe konservimi dhe mbyllja e ish ndërmarrjeve industriale në varësi të MIE-s.

- Eliminimi i rrezikut të dëmtimit të shëndetit të njerëzve dhe mjedisit nga kimikatet e rrezikshme të përdorshme, në gjendje e në kushte të pa sigurt depozitimi.

4.2.6 Programi Buxhetor "Mbështetje për Burimet Natyrore"

Ky program harton, mbështet dhe zbaton proceset dhe politikat për burimet natyrore. Programi ka për qëllim identifikimin e mundësive për një zhvillim të qëndrueshëm në sektorin minerar, nëpërmjet realizimit të politikave të promovimit, mbikqyrjes, monitorimeve si dhe transparencës.

Pjesë e aktiviteteve të këtij programi janë edhe dy institucione varësie:

1. Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, i cili ka si objektiv evidentimin e resurseve të burimeve natyrore minerare, hidrokarbure dhe hidrologjike me qëllim nxitjen e shfrytëzimit maksimal, zhvillimin e mëtejshëm të sistemit të informacionit, bankës së të dhënave për të mundësuar transmetimin në kohë të informacionit drejt vendim-marrësve, si dhe parandalimin e rreziqeve gjeologo-mjedisore, hidrologjike, nëpërmjet kryerjes së studimeve dhe analizave paraprake në mbështetje të pushtetit qëndror dhe lokal.
2. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera, i cili kryen veprimtari inspektimi në fushën e sigurisë në punë, të emergjencave dhe të shpëtimit në veprimtarinë minerare dhe punimet nëntokësore të veprave hidroenergjetike.
3. Qendrën Rajonale të Inovacionit të Institucionit Evropian të Teknologjisë dhe Inovacionit për Lëndet e para.

Politikat e këtij programi synojnë:

- Promovimin e burimeve të pashfrytëzuara të mineraleve të kromit, bakrit dhe ranor silicor, vlerësimi sasior dhe cilësor i rezervave minerare, hartimi i studimeve dhe projekteve gjeologjike, studimi dhe vlerësimi i pasurive natyrore të lëndëve hidroenergjetike. Vlerësimin e rreziqeve gjeologjike mbi qëndrueshmërinë e truallit dhe infrastrukturës publike në shkallë vendi dhe vlerësime emergjente. Mirëadministrimi i territorit në shkallë vendi, nëpërmjet përpilimit të hartave gjeologjike, gjeomjedisore gjeomumenteve.
- Shfrytëzimin me efikasitet të burimeve natyrore minerare nga shoqëritë e licensuara për këtë veprimtari nëpërmjet zbatimit të kushteve tekniko - profesionale dhe mjedisore sipas standarteve europiane.
- Rritjen e transparencës në industrinë nxjerrëse, me qëllim rritjen e cilësisë në mirëqeverisjen e industrisë nxjerrëse.

Qëllimi i politikës së këtij programi është:

- Promovimin e burimeve të pashfrytëzuara.
- Përmirësimi i standarteve në kuadër të sigurisë në miniera dhe ndërhyrjeve shpëtuese.
- Shfrytëzimi me efikasitet të burimeve natyrore minerare nga shoqëritë e licensuara për këtë veprimtari.
- Rritja e transparencës në industrinë nxjerrëse.

4.2.7 Programi Buxhetor "Transporti Detar"

Programi buxhetor "Transporti Detar", ka për qëllim zhvillimin e Shqipërisë nga një vend bregdetar, në një vend të zhvilluar detar i orientuar drejt rritjes ekonomike e integritetit evropian, nëpërmjet përmirësimit të infrastrukturës, kapaciteteve njerëzore, sigurisë dhe sistemit të menaxhimit në porte. Objektivi i këtij programi është kryerja e investimeve prioritare për funksionimin me kapacitet të plotë të porteve dhe përmirësimin e infrastrukturës portuale duke sjellë një rritje të investimeve do të shërbejë në zhvillimin e Shqipërisë, nëpërmjet përmirësimit të infrastrukturës, kapaciteteve njerëzore, sigurisë dhe sistemit të menaxhimit në porte.

4.2.8 Programi Buxhetor "Mbështetje për Energjinë"

Qëllimi i politikës së programit, ka për qëllim të nxisë rritjen e sektorit energjetik përmes mbështetjes buxhetore, për një zhvillim të qëndrueshëm të ekonomisë, nëpërmjet garantimit dhe furnizimit me burime të sigurt energjetike me kosto minimale. Programi mbështetet me fonde buxhetore të nevojshme, për zbatimin e politikave në fushën e energjisë, elektroenergjetike, energjisë së rinovueshme, efikasitetit të energjisë, hidrokarbureve.

Programi buxhetor "Mbështetje për Energjinë", konsiston në :

- Zhvillimin e mëtejshëm të burimeve të qëndrueshme të energjisë, përdorimit eficient të tyre, rritjen ekonomike të shoqëruar me sisteme të integruara rajonale dhe kombëtare të energjisë;
- Diversifikimin e burimeve të energjisë, bazuar në parimet e tregut dhe në përputhje me kërkesën për energji, për zhvillim të qëndrueshëm të ekonomisë, duke garantuar sigurinë dhe cilësinë e furnizimit, mbrojtjen e mjedisit dhe veprimet klimatike, rritjen e mirëqenies me kosto sociale minimale.
- Implementimi i politikave dhe strategjive në zbatim të programit dhe prioriteteve të Qeverisë, si dhe përmbushjen e angazhimeve, në kuadrin e Traktatit të Komunitetit të Energjisë e Direktivave të BE.
- Mbështetje e politikave, në kuadrin ligjor, nënligjor dhe institucional në sektorin energjetik dhe mbështetjen e mëtejshme, për krijimin e kushteve për nxitjen dhe hapjen e tregut energjetik në përputhje me paketën e tretë rregullatore të BE.

4.2.9 Programi Buxhetor "Transporti Rrugor"

Bazuar në objektivin e përgjithshëm të Strategjisë Sektoriale të Transportit dhe Planit të Veprimit, programi buxhetor mbështet :

- Zhvillimin e mëtejshëm të sistemit kombëtar të transportit;
- Përfundimi i akseve të Koridorit VIII dhe të Koridorit Blu, projekte të cilat kanë filluar të ndërtohen dhe janë në listën e Projekteve Strategjike Kombëtare;
- Përmirësimin e qëndrueshmërisë, ndërlidhjen, ndërvëprimin dhe integrimin e infrastrukturës rrugore me sistemin ndërkombëtar dhe evropian të transportit dhe rajonin;
- Financimin për projektet që sigurojnë zgjerimin, rritjen e standardeve dhe mirëmbajtjen e rrjetit kombëtar të rrugëve, me synim krijimin e një transporti të qëndrueshëm;

Qëllimi i Politikës së programit është:

- Të krijohen parakushtet për zhvillimin e sektorëve të tjerë të ekonomisë;
- Të rritet aksesimi i mallrave dhe udhëtarëve në tregti dhe ofrimin e shërbimeve;
- Të kontribohet në mënyrë të konsiderueshme në rritjen e përgjithshme dhe zhvillimin e ekonomisë;
- Rehabilitimi dhe mirëmbajtja e rrjetit të rrugëve nacionale, për të ruajtur investimet e realizuara në infrastrukturën rrugore.

4.2.10 Programi Buxhetor "Transporti Hekurudhor"

Qëllimi i politikës së programit, është integrimi i sistemit hekurudhor shqiptar me atë rajonal dhe evropian në nivel administrativ dhe nivel tekniko-funksional.

Objektiva të programit janë:

- Ruajtja e mjedisit të gjelbër dhe ndërlidhës, në përputhje me objektivat strategjik për zhvillim dhe integrim të Shqipërisë, në sektorin e transportin;
- Transformimi i nivelit teknik në sistemin hekurudhor, duke garantuar sigurinë në lëvizje dhe rritje të performancës në lëvizje të trenave;
- Përmirësimin e infrastrukturës hekurudhore dhe disponibilitetin e mjeteve hekurudhore;

- Ulja e numrit të aksidenteve;
- Rritja e shpejtësisë mesatare të lëvizjes së trenave kundrejt 30 km/orë;

Prioriteti kryesor në fushën e transportit hekurudhor ka qenë dhe mbetet "Reformimi i sektorit hekurudhor për të krijuar një treg të hapur për publikun dhe investitorët privatë".

4.2.11 Programi Buxhetor "Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime"

Qëllimi i politikës së programit, është reformimi i sektorit të Ujësjetës-Kanalizimeve, i cili është prioritet i Qeverisë Shqiptare, në përmbushje të vizionit të Strategjisë Kombëtare për një sistem të besueshëm mbarëkombëtar për furnizimin me ujë dhe kanalizime që plotëson nevojat e një ekonomie në zhvillim, bazuar në:

- Furnizim me ujë të zonave urbane;
- Zgjerimin dhe përmirësimin e furnizimit me ujë të zonave bregdetare;
- Furnizimin me ujë të zonave rurale;
- Mbulimin e kostos operative dhe rritja e performancës së Shoqërive të reja Rajonale;
- Mbulimin me Kanalizime dhe ITUN;

Disa prej kompetencave që ushtron AKUK janë si në vijim:

- Përgatit planifikimin e nevojave për investime për ndërtimin/rehabilitimin/zgjerimin e sistemeve të ujësjetës-kanalizimeve, të impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura (ITUN), bazuar në programet e qeverisë dhe në masterplanet kombëtare sektoriale.
- Orienton nga pikëpamja teknike e menaxheriale dhe bashkëpunon për të gjitha projektet e ujësjetës-kanalizimeve, të ITUN-eve, të financuara nga buxheti i shtetit, buxheti i bashkisë, buxheti i shoqërisë "Ujësjetës-Kanalizime" sh.a., apo institucione financiare ndërkombëtare.
- Koordinon nismat për investime në fushën e ujësjetës-kanalizimeve, në bazë të rëndësisë strategjike, si dhe merr pjesë e ofron këshillime gjatë procesit të hartimit të projekteve në fushën e ujësjetës-kanalizimeve. Përgatit, gjithashtu, projekte zhvillimore dhe projekte pilot, me kërkesë të bashkive, qarqeve dhe ministrive apo institucioneve të tjera të administratës publike.
- Është institucioni përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e procedurave e të programit të monitorimit për shërbimet e furnizimit me ujë.

4.3 VEPRIMET VIJUESE NË NIVELIN E PROGRAMIT BUXHETOR

Veprimet vijuese lidhen me realizimin e buxhetit të vitit 2025 në nivelet maksimale. Sikurse është shpjeguar dhe më lartë në nivel qendror plani i rishikuar për vitin 2025 MIE në vlerë nominale është 7.2 miliard lekë më i lartë, krahasuar me nivelin e periudhës krahasuese të vitit 2024.

5. PROJEKTET KAPITALE

Projektet kapitale prioritare që implementohen nga MIE, sipas programeve buxhetore, me financim nga buxheti i shtetit dhe me financim të huaj, përmendim:

Tavani buxhetor i programit buxhetor "Transporti Rrugor", përbën 60% të totalit të buxhetit të MIE për shpenzimet kapitale.

Tavani buxhetor i programit për shpenzimet kapitale me financim të brendshëm përbën 63.3%, të buxhetit të vitit 2025 për shpenzimet kapitale me financim të brendshëm.

Projektet prioritare me financim të brendshëm janë:

- Zbatimi dhe financimi i projekteve koncesionare të infrastrukturës rrugore të MIE:
 - Ndërtim, operim, mirëmbajtje Rruga e Arbrit;
 - Ndërtim, operim, mirëmbajtje Rruga Orikum-Dukat- Porti i Jahteve;
 - Ndërtim, operim mirëmbajtje rruga Milot- Morinë;
- Zbatimi dhe financimi i projekteve të infrastrukturës rrugore nga Autoriteti Rrugor Shqiptar ndahen në:
- ✓ Ndërtim rruge tip A me katër korsi (2x2), sipas standarteve të reja:

Për këtë grup produkti janë planifikuar fonde në vlerën 10,150,265,354 lekë dhe në sasi 13.94 km. Realizimi i shpenzimeve është në vlerën 10,148,844,109 lekë ose 100% e planit dhe është realizuar 13.94 km ose 100% e planit, ku përmendim projektet:

- Rehabilitim i segmentit rrugor mbikalimi pallati me shigjeta rrethrotullimi Shqiponja Loti 1,3;
 - Plotësimi, rakordimi dhe vazhdimi i punimeve rehabilitim i segmentit rrugor mbikalimi pallati me shigjeta rrethrotullimi Shqiponja Loti 3;
 - Ndërtim i Unazës së jashtme Tiranë, Loti 4+modifikim kontrate, Loti 5+modifikim kontrate, Loti 6; Loti 7;
 - Plotësimi, rakordimi dhe vazhdimi i punimeve Sheshi Shqiponja-Lumi i Tiranës, Loti 1 dhe QMT;
 - Ndërtim i segmentit rrugor Sheshi Shqiponja-Bulevardi i ri-Shkozë, Urat mbi lumin Tirana;
 - Zgjerimi i superstradës Tiranë - Durrës Faza I, Faza II, Faza III;
 - Ndërtim aksi rrugor Elbasan - Papërr Faza I, Faza III;
 - Ndërtim aksi rrugor Papërr - Ura e Grykshit, Faza I; Faza II, Faza III;
 - Ndërtim rruga Kashar - Nyja Vaqarr Loti 1;
- ✓ Ndërtim rruge tip B me dy korsi,
- Për këtë grup produkti janë planifikuar dhe janë realizuar fonde në vlerën 8,836,591,533 lekë dhe në sasi 25.02 km, ose 100% e sasisë së planifikuar. Në këtë produkt janë përfshirë kryesisht tip rruge me dy korsi dhe gjërësi që varion nga 10-17 m, duke përmendur disa objekte të rëndësishme në të cilat punohet me ritme të parashikuara:
- Zgjerimi i rrugës Elbasan - Qafë – Thanë, Faza II, Faza III, Faza IV, Faza V, Faza VI, Faza VII, Faza VIII;
 - Rehabilitimi i rrugës Fier - Kthesa e Patosit – Frataj;
 - Ndërtim rruga kthesa e Bërdicës - Ura e Bahcallëkut;
- ✓ Ndërtim rruge tip C2 me dy korsi,
- Për tipin e rrugës C2 janë planifikuar fonde në vlerën 6,290,539,973 lekë dhe në sasi 63.9 km. Realizimi i shpenzimeve për tipin e rrugës C2 është në vlerën 6,256,194,680 lekë dhe në sasi 59.06 km ose 92.4 % e sasisë së planifikuar. Janë përfshirë kryesisht tip rruge C2 me dy korsi dhe gjërësi që varion nga 7.5-10 m.
- Ndërtim rruga Palas – Dhërmi+ modifikim kontrate;
 - Rikonstruksion i aksit rrugor Maliq-Lozhan i Ri Strelcë + modifikim kontrate;
 - Sistemim asfaltim rruga Ura e Cerencit - Peshkopi (Peshkopi - Maqellarë), Loti 3;
 - Sistemim asfaltim rruga Qafa e Buallit – Martanesh;
 - Ndërtim rruga Berat - Ballaban, Loti 3;
 - Ndërtim rruga Berat - Ballaban, Loti 2;
 - Ndërtim rruga Berat - Ballaban, Loti 1;
 - Rikonstruksion i rrugës së vjetër Kombinat- Ndroq-Plepa, Loti 1;
 - Zgjerimi i rrugës së Ksamilit;

- Ndërtim i rrugëve lidhëse me Tunelin e Llogarasë;
- Ndërtim By Pass Sarandë, Faza I dhe FAZA II;
- Plotësim i punimeve në segmentin rrugor Qukës - Qafë - Pllocë Loti 0;
- Rehabilitim i segmentit rrugor Shijan -Delvinë dhe rruga lidhëse e fshatit Vergo, ndriçimi i rrethrotullimit të Shijanit;
- Sistemim asfaltim rrugët e Drejtorisë së Rajonit Verior Shkodër;
- Sistemim asfaltim rrugët e Drejtorisë së Rajonit Jugor Gjirokastrë;
- Sistemim asfaltim rrugët e Drejtorisë së Rajonit Qendër Perëndim (Tiranë);
- Sistemim asfaltim rrugët e Drejtorisë së Rajonit Qendër Lindje (Korçë);

✓ Qendra e Monitorimit të Trafikut

Në këtë zë janë përfshirë dy projekte të monitorimit të trafikut (Faza e parë dhe Faza e dytë). Për këtë zë janë planifikuar fonde në vlerën 730,955,346 lekë dhe në sasi produkti 86 km. Realizimi faktik në vlerën 602,049,819 lekë dhe në sasi faktike 68 km ose 80% e sasisë së planifikuar.

✓ Sinjalistikë dhe Siguri Rrugore

Për këtë grup produkti janë planifikuar fonde në vlerën 770,188,282 lekë dhe në sasi 389 km. Realizimi i shpenzimeve të këtij grup produkti është 750,140,258 lekë dhe në sasi produkti 386 km ose 99% e sasisë së planifikuar ku përmendim projektet:

- Eleminim i pikave të zeza (Black Spots), në rrjetin rrugor kombëtar 2023;
- Përmirësim i sinjalistikës horizontale, vertikale dhe pajisjeve të sigurisë rrugore në akset e Rajonit Qendër Perëndim, LOTI 2 (2024);
- Përmirësim i sinjalistikës horizontale, vertikale dhe pajisjeve të sigurisë rrugore në akset e Rajonit Jugor, LOTI 3 (2024);
- Eleminim i pikave të zeza (Black Spots), në rrjetin rrugor kombëtar 2024.
- Përmirësim i sinjalistikës horizontale, vertikale dhe pajisjeve të sigurisë rrugore në akset e Rajonit Verior, LOTI 1 (2025);
- Përmirësim i sinjalistikës horizontale, vertikale dhe pajisjeve të sigurisë rrugore në akset e Rajonit Qendër Perëndim, LOTI 2 (2025);
- Përmirësim i sinjalistikës horizontale, vertikale dhe pajisjeve të sigurisë rrugore në akset e Rajonit Jugor, LOTI 3 (2025);
- Përmirësim i sinjalistikës horizontale, vertikale dhe pajisjeve të sigurisë rrugore në akset e Rajonit Qendër Lindje, LOTI 4 (2025);

Tavani buxhetor i programit për shpenzimet kapitale me financim të huaj përbën 42.5% të buxhetit të vitit 2025 për shpenzimet kapitale me financim të huaj. Projektet prioritare me financim të huaj janë:

- Përmirësimi dhe rehabilitimi i Urave;
- Ndërtim segmenti rrugor Qukës – Qafë Pllocë;

Tavani buxhetor i programi buxhetor "Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime", përbën 23% të totalit të buxhetit të vitit 2025 të MIE për shpenzimet kapitale.

Tavani buxhetor i programit për shpenzimet kapitale me financim të brendshëm përbën 21.7% të buxhetit të vitit 2025 për shpenzimet kapitale me financim të brendshëm.

Projektet prioritare me financim të brendshëm janë:

- Rrjeti i kanalizimeve në zonat periferike të qytetit Burrel dhe largimi i ujrave të zeza të fshatit Muzhak;
- Ndërtim ujësjellësi për furnizimin me ujë i qytetit Burrel të fshatrave të njësisë Derjan dhe Rukaj-Loti I;

- Ndërtimi rrjeti furnizimit dhe rrjeti shpërndarës ujësjellësi Lagja Allmet dhe ndërtimi i rrjetit të KUZ lagja e Vjeter qytetit Bulqizë;
- Ndërtimi Ujësjellës rajonal nga Burimet e Përroit të Lopës dhe gurrave të Ketës Faza II;
- Ndërtimi Rrjeti shpërndarës në fshatrat Cerenic i sipërm dhe Cerenic i poshtëm dhe ndërtim depo uji;
- Ndërtim rrjeti kryesor furnizimi me ujë i fshatrave të Njësisë Administrative Maqellarë dhe rrjeti shpërndarës fshati Kërçisht i Sipërm Faza e II;
- Ndërtim i rrjetit ujësjellësit zona industriale (ish rezervat e shtetit-Ura e Hanit), linjës së dërgimit;
- Furnizimi në zonat Bregdetare, Plazhi i Gjeneralit-Bardhor-Karpen-Synej Bashkia Kavajë-Varianti i loti I;
- Rikonstruksioni i rrjetit të ujësjellësit në fshatin Shënavlash, njësia administrative Rrazhbull;
- Sigurimi dhe përmirësimit të rrethimit të burimeve dhe depove të ujit për SHRUK Durrës;
- F.V elektropompa dhe panele elektrike për stacionin e pompave Fushë-Kuqe;
- Rikonstruksioni i nyjes hidroteknike në rezervuarin e Maskurisë;
- Rikonstruksion i impiantit të pastrimit të ujit Maskuri;
- Rikonstruksion dhe ndërtim i rrjetit të kanalizimeve të zonave informale, Harnes pjesërisht Krasta e Vogël, pjesërisht lagja Dyli Haxhirë dhe pjesërisht Lagja Katund i Ri Bashkia Elbasan;
- Ndërtim ujësjellësi i fshatrave Klos, Selvijas, Qyrkan, Lumas dhe Floq, (NJ.A. Klos) dhe rikonstruksion i ujësjellësit të fshatit Selitë (NJ.A. Mollas) Bashkia Cërrik;
- Rikonstruksion i plotë i ujësjellësive të fshatrave Kotorr dhe Stror, si dhe ndërtimi i ujësjellësit të ri, fshati Liras, njësia Administrative Pishaj, Bashkia Gramsh;
- Rikonstruksion magjistrali kryesor dhe rrjetit të brendshëm të ujësjellësit qytetit Patos Loti II
- Rikonstruksion magjistrali kryesor dhe rrjetit të brendshëm të ujësjellësit qytetit Patos Loti III;
- Përmirësimi i furnizimit me ujë të pijshëm të Njësisë Administrative Kurjan;
- Rikonstruksion i ujësjellësit fshati Kafaraj, Çerven, Ade, Bashkia Fier;
- Ndërtim KUZ në lagjen Afrim, Bashkia Fier;
- Ndërtimi i ujësjellësit të fshatrave Drenoce, Beloshovë, Belistan dhe Visokë, Bashkia Mallakastër;
- Ndërtim ujësjellësi i fshatrave të Njësisë Administrative Aranitas, Bashkia Mallakastër;
- Ndërtim i ujësjellësit rajonal për fshatrat Vasjar, Iliras, Qesarat, Ane Vjose, Toc, Lulëzim, Zhulaj, Krahës dhe Qytetin Memaliaj, Bashkia Memaliaj;
- Ndërtimi i linjës së jashtme të furnizimit me ujë me vetërrjedhje për ujësjellësin Rajonal të Bashkisë Dropull+ lidhja e burimit të manxifës me rrjetin ekzistues+ rrjeti i jashtëm dhe depo për fshatin Grapsh dhe Dervican Bashkia Dropull;
- Rikonstruksion i ujësjellësit Rajonal të fshatrave Frashër (Vërçishtë-Gostomickë), Gjinkar, Petran, Rapckë, Loti II-të, Bashkia Përmet;
- Ndërtimi i Ujësjellësit Rajonal për njësinë administrative Golaj, për fshatrat Dobrunë, Qarr i vogël, Golaj, Nikoliq dhe Vlahen, Bashkia Has;
- Ndërtim rrjet ujësjellësi qytetit Mamurras;
- Rikonstruksion i rrjetit të fshatit Dajç, Bashkia Lezhë;
- Furnizimi me ujë i fshatrave Merqi dhe Raboshtë, Bashkia Lezhë;
- Furnizimi me ujë i fshatrave Gorica, Sopez, Senesa, Ferras, Mërtish, Këmishtaj, Spolte, Gradisht, Fier Sema, Gungas, Babunje, Babubje e re në Njësinë Gradisht;
- Ndërtim i rrjetit të KUZ, qyteti Prrrenjas;
- Ndërtim ujësjellësi rajonal Trebinje burimet e Kozicës, Bashkia Pogradec;
- Ndërtimi i sistemit të kanalizimeve të Njësisë administrative Udenisht, Bashkia Pogradec;
- Zgjerimi i rrjetit të kanalizimeve dhe rehabilitimi i stacioneve të pompimit të ujërave të ndotura Ksamili;
- Furnizimi me ujë të pijshëm për fshatrat Pistull, Pacram dhe Spathar, Bashkia Vau i Dejës;
- Ndërtim i ujësjellësit Bardhaj Bleran Bashkia Shkodër;
- Shtesa e Impiantit të përpunimit të ujit të pijshëm, Bovillë 1800l/s faza e II me 1200 l/s;

- Rrjeti shpërndarës i furnizimit me ujë dhe të KUZ të zonës së Fruti Kulturës, Valias i Vjetër, Bashkia Kamëz;
- Rikonstruksion depo dhe ndërtimi i ujësjellësit të fshatit Berxull, Bashkia Vorë;
- Ujësjellësi-zona e Ujit të Ftohtë dhe Lungomares Rrapi Uji i Ftohtë – Shkolla e Marinës;
- Sistemi i furnizimit me ujë të Aeroportit të Vlorës;
- Furnizimi me ujë të zonave bregdetare, zonat e investimit strategjik, Draleos, Drimadhes dhe Dhërmi të Bashkisë Himarë, faza I;
- Ndërtim i Rrjetit të Kanalizimeve nga Lungomare deri në hyrje të Radhimës, Vlorë;
- Furnizimi me ujë i zonave bregdetare, zonat e investimit strategjik, Draleos, Drimadhes dhe Dhërmi të Bashkisë Himarë, faza III;

Tavani buxhetor i programit për shpenzimet kapitale me financim të huaj përbën 22% të buxhetit të vitit 2025 për shpenzimet kapitale me financim të huaj. Në projektet që po implementohen me burim financimi të huaj nga donatorët, përmendim:

- ✓ Infrastruktura Bashkiake, III, IV, V;
- ✓ Programi Kombëtar i Modernizimit të Sektorit të Ujësjellës Kanalizimeve;
- ✓ Projekti i rikonstruksionit të rrjetit të brendshëm për ujësjellësin e Bashkisë Durrës;
- ✓ Projekti i kanalizimeve Tirana e Madhe;

Tavani buxhetor i programi buxhetor "Transporti Hekurudhor", përbën 5% të totalit të buxhetit të rishikuar të MIE për shpenzimet kapitale.

Tavani buxhetor i programit për shpenzimet kapitale me financim të brendshëm përbën 1% të buxhetit të vitit 2025 për shpenzimet kapitale me financim të brendshëm.

Tavani buxhetor i programit për shpenzimet kapitale me financim të huaj përbën 22% të buxhetit të vitit 2025 për shpenzimet kapitale me financim të huaj. Projektet prioritare janë:

- Hartimi i Projektit preliminar Rrogozhinë – Pogradec - Lin (Kufi me Maqedoninë e Veriut);
- Zbatimi i projektit inxhinierik dhe arkitektonik i godinave të stacioneve hekurudhore Durrës - Tiranë TTP – Rinas, Aeroport;
- Zbatimi i punimeve ndërtimore për elektrifikimin e linjës hekurudhore "Durrës - Tiranë dhe ndërtimin e linjës së re hekurudhore për në aeroportin e Rinasit;
- Studim i Fizibilitetit dhe Projekt Ide për lidhjen hekurudhore Durrës–Prishtinë;
- Zbatimi i projektit "Rehabilitimi i linjës hekurudhore Durrës-Rrogozhinë";
- Zbatimi i projektit "Rehabilitimi i linjës hekurudhore Vorë-Hani Hotit";

Tavani buxhetor i programi buxhetor "Mbështetje për Energjinë", përbën 3% të totalit të buxhetit të vitit 2025, të MIE për shpenzimet kapitale.

Tavani buxhetor i programit për shpenzimet kapitale me financim të brendshëm përbën 0.8% të buxhetit të vitit 2025 për shpenzimet kapitale me financim të brendshëm.

Tavani buxhetor i programit për shpenzimet kapitale me financim të huaj përbën 13.2% të buxhetit të vitit 2025 për shpenzimet kapitale me financim të huaj. Projektet prioritare janë:

- Konvikte të rinovuara me eficiencë të energjisë Qyteti Studentit, programi i Rehabilitimit të Konvikteve të Universitetit të Tiranës sipas Parimit të Eficiencës së Energjisë (Faza I, Faza II);
- Mbështetje vazhdimësisë në Transparencën Nxjerrëse;
- Program i Investimeve për Shpërndarjen e energjisë;
- Rehabilitimi i Hidrocentralit të Fierzës (DKTI);
- SCADA (Zgjerimi i sistemit SCADA në godinën Qendrore të OSHEE);

Tavani buxhetor i programeve të tjera buxhetore, përbën 11% të totalit të buxhetit të vitit 2025, të MIE për shpenzimet kapitale.

Tavani buxhetor i programit për shpenzimet kapitale me financim të brendshëm përbën 10.9% të buxhetit të vitit 2025 për shpenzimet kapitale me financim të brendshëm.

Tavani buxhetor i programit për shpenzimet kapitale me financim të huaj përbën 0.01% të buxhetit të vitit 2025 për shpenzimet kapitale me financim të huaj.

6. NDRYSHIMET NË BUXHET

Mbështetur në analizën e performancës së zbatimit të projekteve në vazhdim dhe ecurisë së projekteve prioritare të vitit 2025, ndryshimet e kërkuara të MIE kanë ndikuar në rritjen performancës buxhetore dhe financiare përtej planit të rishikuar të buxhetit për vitin 2025. Ky argumentim është realizimi i zbatimit të akteve ligjore dhe VKM të sipërcituara në buxhetin e rishikuar të vitit 2025.

7. PËRFUNDIME

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë gjatë gjithë vitit buxhetor 2025, ka qënë e angazhuar maksimalisht për një realizim financiar të buxhetit, si në vlera buxhetore ashtu dhe në %, e argumentuar në tërësinë e raportit vjetor të monitorimit të buxhetit për vitin 2025, duke mbajtur si prioritet mos krijimin e detyrimeve të prapambetura për vitin buxhetor pasardhës 2026.